

**UNIVERZITETI I EUROPEJ JUGLINDORE**  
**FAKULTETI EKONOMIK**



**STUDIME POSTDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË**

**Punim Masteri**

**Programi studimorë: Finance dhe kontabilitet**

**Teza: "Analiza e efekteve socio - ekonomike të progresionit tatimorë në rastin e Republikës së Shqipërisë"**

**Mentori:**  
**Akademik Prof.Dr. Abdylmenaf Bexheti**

**Kandidati:**  
**Lulzim Mehmedi**

**Tetovë 2021**

## *Falenderime dhe Mirënjohje*

*Realizimi i një punimi master, kërkon durim dhe mbështetje të shumë personave.*

*Ndjej kënaqësi dhe njëkohësisht detyrim të falenderoj familjen që me shumë sakrifica më ka dhënë mbështetje të pakursyer, në të gjithë rrugëtimin e arsimimit tim dhe jo vetëm.*

*Gjithashtu falenderoj miqtë e afërt të cilët poashtu më kanë qëndruar afër në ç'do sfidë të jetës dhe kanë qenë një nxitje për ç'do arritje timen.*

*Një falenderim i veçantë drejtohet për udhëheqësin tim, Akademikun Profesor Doktor Abdylmenaf Bexheti i cili iu përgjigj pozitivisht kërkesës sime për të qenë mentor në këtë punim. Gjithashtu e falenderoj për mbështetjen, këshillat, kritikën e sidomos për durimin që ka pasur gjatë gjithë këtij procesi.*

*Në fund por jo më pak i rëndësishëm një falenderim dhe mirënjohje shkon për kolegët dhe profesorët e Univerzitetit të Europës Juglindore, duke theksuar Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm duke më ndihmuar në përvetësimin e njohurive të nevojshme për realizimin e këtij punimi.*

*Si përfundim falenderime dhe mirënjohje të panumërta shkojnë për të gjithë ju sepse pa kontributin tuaj ky punim nuk do të mund të realizohej.*

*Ju Faleminderit!*

## PËRMBAJTJA:

1. Hyrje.....	6
2. Qëllimet e studimit.....	6
3. Rishikim i literaturës .....	7
4. Hipotezat e ngritura .....	10
5. Metodologjia e studimit.....	10
6. Rëndësia e studimit.....	11
<b>KAPITULLI I: POLITIKA FISKALE DHE RËNDËSIA E SAJ</b> .....	<b>12</b>
I.1. Nocioni dhe kuptimi i politikës fiskale .....	12
I.2. Rëndësia e politikës fiskale .....	12
I.3. Objektivat e politikës fiskale .....	13
I.4. Roli i politikës fiskale.....	14
I.4.1. Ndikimi i politikës fiskale në aktivitetin ekonomik .....	15
I.4.2. Ndikimi i politikës fiskale në punësim dhe në nivelin e çmimeve.....	15
I.4.3. Ndikimi i politikës fiskale në rishpërndarjen e të ardhurave .....	17
<b>KAPITULLI II: BARRA TATIMORE NË VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN DHE VENDET E BALLKANIT</b> .....	<b>18</b>
II.1. Barra tatimore në vendet e BE.....	19
II.2. Barra tatimore në vendet e Ballkanit.....	20
II.3. Normat tatimore në Ballkan .....	21
II.4. Rritja ekonomike në vendet e Ballkanit .....	24
II.5. Invesimet e huaja në vendet me barrë të ndryshme tatimore.....	26
<b>KAPITULLI III: SISTEMI TATIMORË NË SHQIPËRI GJATË PERIUDHËS 2007- 2012</b> .....	<b>28</b>
III.1. Efektet e krizës globale në Shqipëri.....	31
III.2. Rritja ekonomike gjatë periudhës së tatimit të sheshtë.....	32
III.3. Të ardhurat tatimore të R.Shqipërisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë .....	33
III.4 Investimet e huaja gjatë periudhës tatimit të sheshtë .....	35
III.5 Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit të sheshtë .....	36
III.6. Konsumi i përgjithshëm gjatë periudhës së tatimit të sheshtë .....	38
<b>KAPITULLI IV: SISTEMI TATIMORË NË SHQIPËRI NGA VITI 2013-2020</b> .....	<b>39</b>
IV.1. Rritja ekonomike gjatë periudhës së tatimit progresiv .....	40
IV.2. Të ardhurat tatimore gjatë periudhës së tatimit progresiv.....	42
IV.3 Investimet gjatë periudhës së tatimit progresiv.....	43

IV.4 Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit progresiv.....	44
IV.5 Konsumi i përgjithshëm gjatë periudhës së tatimit progresiv.....	46
IV.6 KRAHASIMI NË MES TË DY PERIUDHAVE TË DY SISTEMEVE TATIMORE NGA ASPEKTI EKONOMIK	47
<b>KAPITULLI V: EFEKTET SOCIALE TË TATIMIT TË SHESHTË GJATË PERIUDHËS 2007 – 2012</b>	<b>52</b>
V.1. Papunësia gjatë periudhës së tatimit të sheshtë.....	52
V.2 Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës 2007-2012 .....	53
V.3 Shpërndarja e të ardhurave në periudhën e tatimit të sheshtë.....	54
V.4 Koeficienti Gini gjatë periudhës së tatimit të sheshtë.....	55
V.5 Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë .....	56
<b>KAPITULLI VI: EFEKTET SOCIALE TË GJATË PERIUDHËS SË TATIMIT PROGRESIV 2013-2019</b>	<b>57</b>
.....	57
VI.1 Papunësia gjatë periudhës së tatimit progresiv .....	57
VI.2 Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës së tatimit progresiv .....	58
VI.3. Shpërndarja e të ardhurave në periudhën e tatimit progresiv .....	59
VI.4. Koeficienti Gini gjatë periudhës së tatimit progresiv .....	61
VI.5. Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit progresiv.....	61
VI.6 KRAHASIMI NË MES TË DY PERIUDHAVE NGA ASPEKTI SOCIAL .....	62
<b>KAPITULLI VII: ANALIZA EMPIRIKE</b> .....	<b>66</b>
VII.1. Qëllimi i analizës empirike dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variables së varur .....	66
VII.2 Përcaktimi i modelit dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variablave të pavarura (shpjeguese) .....	67
VII.3 Rezultatet nga analiza empirike.....	68
VII.4 Testimi i hipotezave .....	69
VII.5. Rezultatet nga aplikimi i tatimit të sheshtë gjatë periudhës 2007 - 2012, dhe tatimit progresiv 2013 - 2019, krahasimi dhe ndikimi i tyre në kontekst ekonomik dhe social në Republikën e Shqipërisë.....	71
<b>KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>72</b>
<b>Bibliografia</b> .....	<b>75</b>

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Normat tatimore në vendet e Ballkanit 2015-2020 .....	21
Tabela 2: Vendet e ballkanit që përdorin sistemin tatimorë progresiv në të ardhura .....	22
Tabela 3: Trendi i rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit gjatë periudhës 2015-2019 .....	24
Tabela 4 : Trendi i investimeve të huaja në vendet e Ballkanit gjatë periudhës 2015-2019 .....	26
Tabela 5: Rritja ekonomike dhe norma e papunësisë në Shqipëri gjatë periudhës 2002-2012 .....	32
Tabela 6: Raporti në mes të rritjes së borxhit dhe rritjes së GDP gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012 .....	37
Tabela 7: Raporti në mes të rritjes së Borxhit Publik dhe rritjes së GDP gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019.....	45
Tabela 8: Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012 .....	53
Tabela 9: Shpërndarja e të ardhurave nëpër shtresa në periudhën e tatimit të sheshtë 2007-2012 .....	54
Tabela 10: Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019.....	58
Tabela 11: Shpërndarja e të ardhurave gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	60

## LISTA E GRAFIKONËVE

Grafiku 1: Barra tatimore si % e PBB-së, në vendet e Bashkimit European për vitin 2019 .....	19
Grafiku 2: Barra tatimore si % e PBB-së, në vendet e Ballkanit në vitin 2019 .....	20
Grafiku 3 Të ardhurat tatimore gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012 .....	34
Grafiku 4: Investimet e huaja në Shqipëri gjatë periudhës së tatimit të sheshtë.....	35
Grafiku 5: Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012.....	37
Grafiku 6: Konsumi gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012 .....	38
Grafiku 7: Rritja ekonomike gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	40
Grafiku 8 Të ardhurat tatimore dhe nga T.P gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	42
Grafiku 9: Investimet gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019.....	43
Grafiku 10: Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	44
Grafiku 11: Konsumi gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	46
Grafiku 12: Norma e papunësisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012 .....	52
Grafiku 13: Kueficienti Gini gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012 .....	55
Grafiku 14 Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012.....	56
Grafiku 15: Norma e papunësisë gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	57
Grafiku 16: Koeficienti Gini gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	61
Grafiku 17: Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019 .....	62

## 1. Hyrje

Një ndër diskutimet më të mëdha në lidhje me sistemin tatimorë është nëse do të hartohet një sistem tatimorë që do të ketë si objektiv drejtësinë apo ndryshe thënë taksimin e ndershëm dhe zvoglimin e dallimit në mes të shtresave që është tatimi progresiv në të ardhura apo do të ketë si objektiv efikasitetin duke krijuar klimë të favorshme për investimet e jashtme, rritje të punësimit, rritje ekonomike etj. që është tatimi i sheshtë.

Mbrojtësit e idesë së tatimit të sheshtë shpjegojnë se norma sa më të ulëta tatimore, mundësojnë që tju ngelin më shumë para njerëzve pas tatimit, gjë që do të mundësonte një mirëqenie më të mirë. Poashtu normat e ulëta tatimore nxisin kurisimet dhe investimet të cilët ndikojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe produktivitetit etj.

Nga ana tjetër, skeptikët e këtij këndvështrimi gjykojnë se norma më të larta tatimore janë të nevojshme sepse ndikojnë në zvoglimin e deficitit ( i cili në këndvështrim afatgjatë është prioritet) dhe poashtu vlerësojnë se normë tatimore më e lartë në të ardhurat e larta do të moderonte pabarazinë e të ardhurave dhe do të ndryshonte shpërndarjen e "kulaçit" nëpër familje.

Sipas një studimi amerikan (Hungerfort, 2012) i publikuar nga qendra për kërkime e Kongresit Amerikan në lidhje me ndikimin që ka pasur norma e lartë marginale në ekonominë Amerikane pas Luftës së Dytë Botërore e deri pas viteve 2000, arrin në konkluzion se vendosja e një norme të lartë marginale nuk ka ndikim në aktivitetin ekonomik dhe se nuk është në korelacion me kursimet, investimet dhe rritjen e produktivitetit. Ndërsa nga ana tjetër një normë e ulët e kësaj takse ndikon në rritjen e pabarazisë apo përqëndrimin e të ardhurave tek të pasurit.

## 2. Qëllimet e studimit

Siç e përmendëm edhe më sipër mungesa e shtresës së mesme është një problem shumë kompleks. Një shoqëri me dy shtresa, ku të pasurit bëhen edhe më të pasur ndërsa të varfërit varfërohen më tepër nuk është një shoqëri e shëndoshë sepse gjithëmonë mes tyre do të ketë një barrierë të lartë e cila vazhdimisht zmadhohet.

Shtresa e mesme si në vendet në tranzicion, poashtu edhe në vendet e zhvilluara është shumë e rëndësishme pavarësisht se ka pësuar goditje të mëdha nga krizat ekonomike, sociale dhe politike. Kjo shtresë është motorri i ekonomisë sepse është konsumatori kryesorë dhe kjo pjesë e shoqërisë është e lidhur ngushtë me të ashtuquajturën biznesi i vogël i cili mundohet të ekzistojë me përpjekje dhe punë të vazhdueshme.

Pra rëndësia e këtij punimi është në kthimin e vëmendjes dhe mbështetjen e asaj pjese të shoqërisë e cila përbën bazën e konsumit dhe vazhdimisht punon për një mirqenie më të mirë.

Tatimimi është mekanizëm që shteti e përdor për mbledhjen e të ardhurave me anë të të cilave do të finançojë shpenzimet që kanë të bëjnë me shërbimin dhe të mirat publike siç janë infrastruktura, edukimi, shëndetësia etj.

Shpërndarja e drejtë e barrës tatimore është çështje mjaft komplekse mbi të cilën janë ndërtuar shumë modele për të arritur tek një zgjidhje optimale e cila do të jepte efekte pozitive në aspekt makro dhe mikro por kjo nuk mund të arrihet lehtë sepse tatimimi është obligim ligjorë për çdo person fizik apo juridik por çështja që mund të diskutohet është se cili do ngarkohet më shumë apo cili do të lehtësohet më shumë.

Prandaj çdo gjë varet nga ajo se çfarë objektivi ka shteti, çfarë strategjie do të përdorë, cilën filozofi do të mbështesë. Do të përdor normën e sheshtë tatimore apo do të përdorë progresionin tatimorë?!

### 3. Rishikim i literaturës

Lidhur me sistemin tatimorë dhe me efektet e tij në indikatorët makroekonomik, janë bërë shumë studime si nga studiues vendorë ashtu edhe nga studiues të jashtëm meqenëse është një problem mjaft kompleks.

Kur përmendet sistemi tatimorë, automatikisht vjen në shprehje qasja të cilën do të ketë qeveria ndaj mbledhjes së taksave, edhe atë duke zgjedhur që të fokusohet në dizajnimin e një sistemi të tillë tatimorë i cili do të ketë fokusin në krijimin e një klime atraktive për investitorët e huaj apo do të fokusohet në taksimin e ndershëm dhe barazinë me qëllim të zvoglimit të dallimit në mes të shtresave.

Disa nga studimet që janë bërë në lidhje me sistemin tatimorë dhe lidhjen e tij me indikatorët ekonomik si rritja ekonomike, borxhi publik, investimet, papunësia etj. janë:

#### **STUDIME TË HUAJA:**

(Hungerfort, 2012)

**“Taxes and the Economy: An economic analysis of the Top Tax Rates Since 1945”**

Sipas këtij studimi, autori arrin në konkluzionin që ndryshimet në normat e tatimit të të ardhurave margjinale në 65 vitet e kaluara në SHBA nuk rezultojnë që ka pasur efekt në rritjen ekonomike, kursimet, investimet dhe rritjen e produktivitetit. Nga ana tjetër gjithashtu duke u bazuar në studim, ekziston një lidhshmëri në mes të normave margjinale të tatimit dhe shpërndarjes së të ardhurave. Dhe si përfundim nga studimi kemi që sa më të ulta të jenë normat e taksave margjinale, aq më e madhe do të jetë pabarazia në të ardhura.

(Buffet, April 2012)

#### **“The Buffet Rule: “A basic principle of tax fairness”**

Sipas një studimi të bërë, si pasojë e taksave joeficiente, njerzit më të pasur në Amerikë nga viti 1979 e kanë shtuar pasurinë e tyre rreth 4 herë ndërsa 60 % e popullësisë e cila konsiderohet si shtresa e mesme e kanë shtuar pasurinë e tyre rreth 40% dhe kjo si pasojë e ngarkesës së lartë tatimore mbi të ardhurat nga paga dhe lejimi i taksave të ulta në të ardhura nga investimet.

(Okun, 1975)

#### **“Equality and Efficiency: The Big Tradeoff”**

Pas një studimi të kryer rreth barazisë dhe efikasitetit, përsëri e përmbyll studimin e tij me atë se nuk do të ekzistojë një vijë absolute që do të ndajë efikasitetin nga barazia por gjithëmonë duhet të kërkojmë një miks të të dyjave për të pasur efektet që dëshirojmë në ekonomi.

### **STUDIME VENDORE:**

(Shahi & Tufa, 2017)

#### **“Si ndikon sistemi fiskal në zhvillimin ekonomik në Shqipëri”**

Sipas këtij studimi, objektivi për ndërtimin e një sistemi taksash mirë të dizajnuar është që të shmangen taksat e larta shtrebnëuese dhe të mblidhen të ardhura nga ato që janë më pak shtrebnëuese. Shumë modele vërtetojnë që taksat në investime dhe në të ardhura kanë një efekt vendimtarë në rritjen ekonomike sepse reduktojnë kthimet nga investimet private.

(Hoxha & Koçi, 2013)

#### **“Rritja ekonomike: Një studim ekonometrik për të përcaktuar faktorët ndikues për Shqipërinë”**



Te dy autorët janë bazuar në studimin e (Šokčević & Štokovac) dhe pas dy studimeve ekonometrike në dy periudha të ndryshme, në studimin e parë 1998-2012 përmes regresionit, si faktorë ndikues në rritjen ekonomike morën inflacionin i cili çuditërisht kishte ndikim pozitiv në rritjen ekonomike ndryshe nga teoria por në rastin e Shqipërisë mund të shpjegohet për shkak të viteve 96-97 ku Shqipëria kaloi një kolaps ekonomik për shkak të firmave piramidale , deficioni buxhetorë poashtu ka ndikim negativ, eksportet kanë efekt pozitiv, një bilanc pagesash i balancuar ka poashtu ndikim pozitiv në rritjen ekonomike dhe si faktorë i fundit i analizuar janë edhe investimet e huaja të cilat poashtu rezultuan me efekt pozitiv në rritjen ekonomike. Sa i përket studimit të dytë 2000-2007 , si faktorë ndikues u morën papunësia e cila rezultoi me efekt negativ në rritjen e PBB-së, eksportet me efekt pozitiv dhe produktiviteti i punës poashtu me efekt pozitiv.

(Fejzulla, Lleshi , & Sako, 2015)

#### **“Borxhi publik dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike. Qasje ekonometrike për periudhën 2005-2014”**

Nga modeli i ndërtuar në këtë studim rezulton se rritja e borxhit publik dhe rritja e inflacionit çojnë në uljen e rritjes ekonomike. Koeficienti i përcaktimit na tregon që 76% e variancës së rritjes ekonomike varet nga variacioni i borxhit publik dhe inflacionit.

(Shano, 2018)

#### **“Borxhi Publik dhe nevoja për të ristrukturuar ekonomine shqipëtare”**

Dritan Shano mban qëndrimin që nëse e analizojmë Produktivitetin marginal të Borxhit Publik , do të shohim që borxhi i marrë nuk është i arsyetuar mjaftueshëm me rritje ekonomike. Sipas tij Shqipëria ka gabuar me prioritetet që ka financuar sepse ka financuar projekte, rëndësia metaforike e të cilave është shumë më e madhe se rëndësia ekonomike e tyre.

(Mehmeti & Etemi, 2014)

#### **“Taksa progresive përballë taksës proporcionale”**

Duke u bazuar në studimin e bërë dhe duke nxjerrur në pah avantazhet dhe disavantazhet e taksës së sheshtë dhe taksës progresive, arrijmë në konkluzion që taksa progresive është një sistem më optimal taksimi sepse ne nuk mund të mbështesim taksën e sheshtë duke u mbështetur në arsyen që kjo taksë zvoglon informalitetin dhe evazionin fiskal sepse ne automatikisht mbështesim më së shumti tonë në përpjekjen për të kryer siç duhet mbledhjen e taksave në vend që të ndodhi ndryshe.

## 4. Hipotezat e ngritura

Mungesa e eksperiencës në lidhje me sistemin tatimorë ka bërë që Shqipëria të bëjë reforma të shpeshta tatimore me qëllim të përmirësimit dhe modernizimit. Gjithashtu edhe ndryshimi i pushteteve në mes të atij socialist dhe demokrat ndër vite ka bërë që ç'donjëra palë që ka ardhur në pushtet të bëjë reforma të sistemit tatimorë duke e përshtatur atë me pikëpamjet e tyre ekonomike dhe politike për të arritur objektiva të caktuara.

Një ndër reformat më të shpeshta dhe që ka ngjallur debate të mëdha në efektet që përcjell është reforma e kalimit nga taksë e sheshtë në taksë progresive prandaj edhe në këtë punim masteri është trajtuar tema “Analiza e efekteve socio - ekonomike të progresionit tatimorë në rastin e Republikës së Shqipërisë”. sepse aplikimi i një politike të tillë fiskale në rastin e Shqipërisë është një sfidë më vete edhe pas gjithë atyre kritikave mbi efektet që jep kjo formë e tatimit.

Hipotezat mbi të cilat është bazuar ky punim janë:

**H1:** Një tatim progresiv mbi të ardhura në rastin e Shqipërisë përcillet me një rritje ekonomike të ngadalësuar.

**H2:** Tatimi progresiv ndikon pozitivisht në uljen e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave.

**H3:** Një sistem tatimorë progresiv ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave tatimore.

**H4:** Sistemi tatimorë progresiv ka impakt pozitiv në investimet e huaja.

**H5:** Tatimi progresiv ndikon në uljen e varfërisë.

**H6:** Sistemi tatimorë progresiv ndikon pozitivisht në stabilizimin dhe uljen e borxhit publik.

## 5. Metodologjia e studimit

Duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e këtij hulumtimi , gjatë mbledhjes së të dhënave do të përdoren teknika dhe metoda të ndryshme me anë të të cilave do të tentojmë të fuqizojmë argumentin dhe konkluzionin e arritur .

Një ndër metodat që do të përdoret është metoda e analizës, me anë të të cilës do të analizohen dokumente dhe raporte zyrtare, punime shkencore, libra, artikuj të ndryshëm të

cilat kanë lidhje me tatimet dhe taksat, mënyrën e vjeljes së tyre dhe efektet që japin këto tatime në indikatorët ekonomik.

Gjithashtu do të përdoret metoda statistikore, metodë e cila na ndihmon që përmes tabelave dhe grafikëve të shohim ndryshimin numerik dhe grafik të të ardhurave buxhetore nga tatimet apo edhe të indikatorëve tjerë të cilët do të ndikohen nga aplikimi i normës progresive tatimore apo normës së sheshtë.

Këto të dhëna do të grumbullohen nga web faqe zyrtare të institucioneve të Republikës së Shqipërisë siç është Ministria e financave, Instituti i statistikave, Drejtoria e përgjithshme e tatimeve etj, dhe poashtu nga Banka botërore.

Poashtu kemi edhe metodën krahasuese metodë e cila na ndihmon që të arrijmë në një konkluzion më konkret ku pasi bëhet krahasimi në mes të periudhave kohore kur është aplikuar norma e sheshtë dhe periudhave kohore kur është aplikuar norma progresive tatimore, mund të bëjmë diferencën konkretisht dhe të shohim efektet pozitive dhe negative të secilit prej tyre.

## 6. Rëndësia e studimit

Dilemat në lidhje dizajnimin e sistemit tatimorë vazhdojnë të tërheqin vëmendjen e të gjithë politikanëve, ekonomistëve apo qoftë edhe njerëzve të thjeshtë. E gjithë kjo ndodh për faktin se sistemi tatimorë ka ndikim të drejtpërdrejtë në xhepin e qytetarëve dhe të kompanive.

Përpjekjet për të zhvilluar një sistem optimal taksimi vazhdojnë edhe nga ana e institucioneve dhe organizatave të ndryshme duke bërë studime të ndryshme të kësaj fushe me qëllim që të arrijnë impaktin efikas dhe efektiv si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin social.

Rëndësia e këtij studimi konsiston në analizën dhe qartësimin e dilemave në lidhje me sistemin tatimorë progresiv dhe të sheshtë në vendet në tranzicion apo më konkretisht duke marrë si shembull rastin e Shqipërisë.

Ky studim është shembull konkret për të thyer tabutë që “tatimi i sheshtë në të ardhura është sistemi më optimal në vendet në tranzicion” dhe një dëshmi në vete që sistemi tatimorë progresiv ka dhënë efekte më të mira në rastin e Shqipërisë. Domethënë përzgjedhja e sistemit tatimorë nuk mund të përcaktohet vetëm në bazë të zhvillimit të vendit por duhet marrë parasysh edhe shumë faktorë tjerë ekonomik dhe social të cilët e përfaqësojnë atë vend.

# KAPITULLI I: POLITIKA FISKALE DHE RËNDËSIA E SAJ

*The country needs fiscal discipline to build a strong economy and for social justice.*

**Smriti Irani**

## I.1. Nocioni dhe kuptimi i politikës fiskale

Për të bërë shpenzime, ne së pari duhet të kemi të ardhura. E njëjta logjikë funksionon edhe me shtetin i cili në fillim duhet të grubullojë të ardhurat përmes tatimeve dhe taksave dhe pastaj të planifikojë shpenzimet përgjatë vitit të projektuar. Politika fiskale është mjeti që shteti përdor për të vjelur të ardhurat nga taksapaguesit përmes vendosjes së normave tatimore me qëllim që të financojë shpenzimet e parashikuara për të dhënë efekte ekonomike dhe sociale.

Bashkë me politikën monetare me anë të së cilës banka qendrore rregullon ofertën monetare të një shteti përbëjnë dy instrumentet themelore të cilat përdoren të kombinuara për të arritur objektivat e ndryshme ekonomike. (Bexheti, 2017). Varësisht nga orientimi politik dhe filozofia politike e atyre që janë në pushtet në një periudhë të caktuar, do të varet edhe ajo se cila politikë do të dominojë më shumë, ajo fiskale apo ajo monetare.

Domethënë menaxhimi i mirë i këtyre dy politikave në situata të caktuara ekonomike do të bënte më të lehtë arritjen e objektivave të planifikuara në aspekt afatshkurtë dhe gjithëmonë duke pasur kujdes aspektin dhe pasojat afatgjate sepse ç'do politikë e gabuar ekonomike, goftë fiskale apo monetare rezulton me një kosto shumë të lartë për ekonominë.

## I.2. Rëndësia e politikës fiskale

Politika fiskale është e bazuar në idetë parimore të ekonomistit Anglez John Maynard Keynes i cili besonte se qeveritë mund ti stabilizojnë ciklet biznesore dhe të përmirësojnë ekonominë duke rregulluar shpenzimet qeveritare dhe politikën tatimore për të mbuluar luhatjet e sektorit privat.

Keynes i ndërtoi idetë e tijë gjatë kohës së depresionit të madh, një krizë botërore e cila zgjati nga viti 1929 deri në vitin 1941 duke filluar nga Shtetet e Bashkuara e duke u zgjeruar në pjesën tjetër të globit. (Keynesian Economics)

Rëndësinë e politikave fiskale mund ta vërejmë në ç'do kohë, sidomos në kohët e vështira kur ekonomia pëson goditje të ndryshme nga faktorë të ndryshëm dhe i vetmi instrument

bashkë me politikën monetare që përdoren për të krijuar një mjedis të përshtatshëm ekonomik dhe biznesorë është politika fiskale.

Meqenëse sektori privat është mushkëria e sektorit publik, goditjet më të mëdha direkte i ka ky sektor prandaj një politikë fiskale dhe monetare e atillë që do të ndihmonin ringrintjen e këtij sektori gjatë ç'do goditje dhe jo vetëm, do të ishte jetike për ekonominë në përgjithësi.

Pra politika fiskale në vetvete kërkon një strategji që duhet përdorur në mënyrë që të maksimalizojmë mirëqenien ekonomike shtetërore duke tentuar të vjelim sa më shumë taksa dhe tatime për të bërë investime dhe shërbime por njëkohësisht duke dëmtuar sa më pak mirëqenien ekonomike të sektorit privat apo të taksapaguesve në përgjithësi.

### I.3. Objektivat e politikës fiskale

Përpara se të vendoset se çfarë politike fiskale do të zbatohet , në fillim duhet të kemi parasyshë objektivat e vendosura në mënyrë që të zgjedhim mjetin e duhur për të arritur qëllimin.

Objektivat e politikës fiskale janë të lidhura ngushtë me mirëqenien e përgjithshme ekonomike dhe sociale, standardin jetësorë dhe zhvillimin e vendit .

Si objektiva themelore të politikës fiskale janë:

- Financim i shëndoshë i shpenzimeve publike
- Normë e lartë e punësimit
- Rritje e zhvillimit ekonomik
- Stabiliteti i çmimeve
- Stabiliteti i bilancit pagesorë
- Stimulim i kursimeve
- Stimulim i investimeve
- Rritjen e avantazheve konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore
- Rritjen e cilësisë së shërbimeve publike si arsimi, shëndetësia etj. (Bexheti, 2017)

Realizimi i këtyre objektivave është qëllimi parësorë i ç'do qeverie pavarësisht kompleksitetit për tu arritur këto objektiva sepse siç e dimë, në ekonomi ç'do ndryshim në një indikatorë ekonomik përcillet me efekte në indikatorë të tjerë dhe kjo ndodh sepse faktorët tjerë nuk mund ti mbajmë konstant.

Për shembull nëse duam të bëjmë stimulimin e një ekonomie të ngecur duke përdorur politikën ekspansive, respektivisht rritjen e shpenzimeve apo uljen e taksave, kjo ndiqet me

një risk në rritjen e normës së inflacionit. Kjo ndodh sepse një rritje e parave të lëshuara në treg, qon në rritjen edhe të kërkesës agregate e cila rezulton në rënien e vlerës së paras që do të thot se do të kemi nevojë për më shumë para për të blerë diçka vlera e së cilës nuk ka ndryshuar.

#### I.4. Roli i politikës fiskale

Shpenzimet dhe taksat e shtetit kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën ekonomike të një vendi. Politika fiskale bashkë me politikën monetare janë dy instrumentet themelore që përdoren për arritjen e qëllimeve makroekonomike.

Politika fiskale është e lidhur me shpenzimet qeveritare dhe të politikën tatimore meqenëse ka për qëllim të ndikojë në kërkesën agregate, të stimulojë rritjen ekonomike, të arrijë punësim të lartë, të mos rrisë borgjin publik etj. Varësisht nga situata ekonomike , politika fiskale mund të jetë ekspansioniste dhe restriktive.

Ekspansion fiskal do të thotë ulje e normave tatimore ose rritje e shpenzimeve qeveritare duke pasur si qëllim rritjen e kërkesës agregate dhe konsumit. Kjo politikë zbatohet kur ekonomia po rritet me ritme të ngadalshme dhe papunësia është e madhe dhe me këto dy lëvizje strategjike në politikën fiskale ofrohet një sasi më e madhe parash në treg për ti shfrytëzuar për nevoja të ndryshme ku në mënyrë direkte ndikohet në rritjen e konsumit apo investimeve dhe në mënyrë indirekte ndikohet në rritjen e punësimit dhe përshpejtimin të zhvillimit ekonomik.

Nga ana tjetër një politikë fiskale restriktive do të thotë një ulje e shpenzimeve qeveritare dhe një rritje e normave tatimore. Kjo politikë fiskale zbatohet në rastet kur duam të ngadalsojmë shtimin ekonomik apo duam të ulim inflacionin. Me këtë politikë zvoglohet paraja në treg përmes normave të larta tatimore e cila automatikisht zvoglon kërkesën agregate dhe konsumin dhe kjo politikë ndikon në rritjen e çmimeve të përgjithshme në ekonomi. (Politika fiskale – Objektivat, instrumentet)

Financimi i shpenzimeve qeveritare bëhet nga të ardhurat e grumbulluara në buxhetin shtetërorë por kur këto nuk janë të mjaftueshme , ekziston mundësia e financimit përmes huamarrjes dhe përmes emetimit të parasë përmes politikës monetare.

Vendimet se cila nga politikat fiskale do të zbatohet varen edhe nga reagimet e publikut lidhur me drejtimin dhe veprimet e qeverisë dhe nga faktorët e jashtëm duke u bazuar në politikat fiskale që zbatojnë vendet tjera të rajonit.

#### I.4.1. Ndikimi i politikës fiskale në aktivitetin ekonomik

Një ndër objektivat themelore të politikës fiskale është edhe rritja ekonomike prandaj edhe politikat duhet të orientohen drejtë modeleve ekonomike dhe planeve zhvillimore të atilla që do të orientohen kah rritja dhe zhvillimi ekonomik.

Një ndër matësit e rritjes apo zhvillimit ekonomik është edhe Bruto Prodhimi Vendorë apo PBB i cili gjatë një cikli ekonomik apo viti fiskal nëse është rritur themi se kemi rritje ekonomike ndërsa nëse kemi zvoglim krahasuar e me vitin paraprak atëherë përballemi me rënie ekonomike.

Shteti duke implementuar dhe manipuluar me politikën fiskale tenton të arrijë në rezultate të tilla të cilat përmirësojnë standardin jetësorë dhe rrisin nivelin e konsumit dhe gjithë aktivitetin ekonomik por gjithëmonë duke tentuar të ruaj stabilitetin e inflacionit.

Një normë optimale e rritjes ekonomike mund të arrihet vetëm nëse kemi stabilitet të lartë ekonomik dhe politik, sepse nëse ekziston frika, pasiguria dhe pesimizmi tek sektori privat dhe tek konsumatorët, kjo do të rezultonte me recesion ekonomik dhe depresion, dhe e kundërta, dmth nëse ofrohet siguria e duhur, të gjithë bizneset do të tentojnë të shfrytëzojnë maksimalisht faktorët e prodhimit për të arritur profitabilitet sa më të lartë gjë që përmes multiplikatorëve, jep efekte të mëdha dhe reale në ekonominë e përgjithshme dhe në aktivitetin ekonomik. (Politika fiskale – Objektivat, instrumentet)


#### I.4.2. Ndikimi i politikës fiskale në punësim dhe në nivelin e çmimeve

Stabiliteti i çmimeve është një ndër objektivat themelore të Bankave Qëndrore në mbarë botën, objektivi i cili theksohet si meritë e suksesit të tyre në kuadër të politikave monetare. Gjithashtu edhe pavarësia e Bankave Qëndrore në zgjedhjen e instrumenteve me të cilët do të arrihet ky objektivi e dëshmon këtë meritë.

Pra nuk mund të përjashtohet roli i Bankës Qëndrore në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve por duhet theksuar se pavarësisht se inflacioni është fenomen monetarë, rol gjithashtu të rëndësishëm në realizimin e këtij objektivi ka edhe politika fiskale.

Me këtë kuptojmë që Banka Qëndrore nuk mund të jetë indiferente ndaj politikës fiskale gjatë zgjedhjes së instrumenteve për ruajtjen e inflacionit por gjithëmonë politika monetare dhe politika fiskale duhet të jenë në kordinim me njëra tjetrën për të arritur qëllimin e përbashkët sepse ndryshe moskordinimi do të sjellë efekte të kundërta të cilat sjellin kosto në ekonomi.


P.sh në rastet e mëposhtme është paraqitur grafiki situata kur ekonomia gjendet në ekuilibër në pikën  $E_1$ . Supozojmë që qeveria vendos të aplikojë një politikë fiskale ekspansioniste ku si pasojë e rritjes së shpenzimeve qeveritare ose uljes së taksave , do të rritet kërkesa agregate dhe lakorja e kërkesës  $AD_1$  do të zhvendoset djathtas në  $AD_0$ . Me këtë zhvendosje, poashtu kemi edhe rritje të çmimit të produkteve në treg dhe poashtu meqenëse kemi rritje të kërkesës agregate, kemi edhe rritje të të ardhurave të cilat kalojnë nga pika  $Y_1$  në  $Y_0$ . Me këtë kuptojmë që kemi zhvendosje të ekuilibrit ekonomik nga pika  $E_1$  në pikën  $E_0$ .



politika fiskale ekspansioniste

Në figurën 2 kemi rastin e kundërt kur qeveria vendos të zbatojë një politikë fiskale restriktive, ku me zvoglimin e shpenzimeve joqeveritare ose rritjen e normave tatimore, do të kemi një zvoglim të kërkesës agregate e cila do të zhvendoset nga  $AD_1$  në  $AD_0$ . Me uljen e kërkesës agregate, do të kemi ulje të çmimit nga  $Ç_1$  në  $Ç_0$  dhe gjithashtu uljen e të ardhurave nga  $Y_1$  në  $Y_0$ . Me këtë kemi zhvendosje të ekuilibrit ekonomik nga  $E_1$  në  $E_0$ .

Gjithashtu për sa i përket relacionit të politikës fiskale me punësimin, në momentin që aplikohet një politikë fiskale ekspansioniste, kemi rritje të kërkesës agregate dhe gjithashtu edhe rritje të normës së punësimin. Në momentin që qeveria aplikon politikë fiskale restriktive , kemi ulje të kërkesës agregate dhe gjithashtu ulje të normës së punësimin. (Politika fiskale – Objektivat, instrumentet)



politika fiskale restriktive



### I.4.3. Ndikimi i politikës fiskale në rishpërndarjen e të ardhurave

Gjatë 20 viteve të fundit, dallimi në mes të shtresave dhe pabarazia në të ardhura është një ndër diskutimet e shpeshta që bëhet sepse si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në tranzicion, ky fenomen ka marrë një trend rritës të lartë dhe shqetësues.

Në vendet në zhvillim , pabarazia është më e theksuar dhe kjo ndodh si rezultat i politikave fiskale të gabuara me anë të të cilave do të duhej të ndikohej më shumë duke e zvogluar këtë pabarazi.

Politika fiskale është instrumenti kryesorë me anë të të cilit qeveritë ndikojnë në rishpërndarjen e të ardhurave dhe tentojnë ta ngadalsojnë dhe ta zvoglojnë këtë trend rritës. Ekzistojnë shumë mënyra me anë të të cilave qeveritë përmes politikës fiskale tentojnë të kenë një impakt direkt apo indirekt në të ardhurat e familjeve edhe atë:

- Përmes shpenzimeve qeveritare
- Ndihma për të papunët
- Asistencë sociale
- Pensionet shtetërore
- Edukimi falas
- Kujdesi shëndetësorë falas dhe Strehim social etj.

Përmes tatimit:

- Tatimi progresiv në të ardhura
- Rritja e normave margjinale dhe mesatare me rritjen e të ardhurave
- Lirimi nga tatimimi i familjeve me të ardhura të ulta
- Taksa e pasurisë
- Taksat konsumit tek familjet me të ardhura të ulta etj

Të dy llojet e politikave në kuadër të politikës fiskale , ajo tatimore dhe e shpenzimeve duhet që të dizajnohen me kujdes që të arrihen të realizohen objektivat e rishpërndarjes dhe ato të efijencës, pa mos i përjashtuar objektivat tjera të politikës fiskale. (Politika fiskale – Objektivat, instrumentet)

## KAPITULLI II: BARRA TATIMORE NË VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN DHE VENDET E BALLKANIT

*Reducing the tax burden is necessary to produce economic growth.*

**Bob Schaffer**

Zbatimi i politikave fiskale duke u bazuar në modelet ekonomike dhe sociale të cilat janë të marra shembull nga vendet e zhvilluara nuk mund të japin të njejtat efekte që kanë dhënë atje për shumë arsye. Një ndër arsytet është se çdo model ekonomik duhet të ndërtohet në bazë të situatës reale ekonomike dhe atëherë mund të kemi rezultate dhe efekte të pritshme.

Qeveritë duhet të mbështeten në sisteme tatimore që promovojnë politika nxitëse, motivuese dhe mbështetëse për investitorët, të jashtëm apo të brendshëm, sidomos për bizneset e vogla me qëllim të nxitjes së funksionimit të tregut sepse tregu është rregullatori më i mirë kur konkurrenca është më e madhe.

Totali i detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore duke u bazuar në nivelin e të ardhurave që duet të paguhen nga tatimpaguesit përbëjnë barrën tatimore.

Matja e barrës tatimore përcakton se si politika fiskale realizon objektivin e saj në rritjen e të ardhurave duke mos mbingarkuar tatimpaguesit me të ardhura të larta sepse pasojat do ishin në demotivimin e tyre për të investuar, por gjithashtu duke tentuar që të ruaj barazinë e ngarkesës tatimore bazuar në aftësinë paguese.

Më poshtë kemi një analizë të barrës tatimore në vendet e EU dhe Gadishullit Ballkanik, me qëllim që të shohim politikat fiskale apo më sakt ngarkesën tatimore të vendeve të rajonit të cilët përfaqësojnë gjenden në situatë ekonomike të ngjashme .

Kjo gjithashtu është edhe në interes të çdo qytetari meqenëse çdonjëri është tatimpagues dhe kontribues në buxhetin e shtetit , goftë në mënyrë direkte apo indirekte dhe ka të drejtë të jetë i informuar në lidhje me barren tatimore që janë të ngarkuar qytetarët në vendet fqinje.

Të ardhurat nga tatimet definoohen si të ardhura të grumbulluara nga tatimi në të ardhura, tatim fitimi, kontributet sociale , tatimi në të mira dhe shërbime, taksat mbi pronësinë, transfere të pronësisë dhe taksa të tjera.

Totali i të ardhurave tatimore në raport me GDP-në, na tregon barren tatimore të një vendi dhe poashtu mund të jetë një tregues i shkallës në të cilën qeveria kontrollon burimet e ekonomisë .


Tek totali i të ardhurave nga barra tatimore përfshihen :

- Tatimet mbi të ardhurat personale
- Tatimi në fitim
- Tatimi në vlerën e shtuar (TVSH)
- Akcizat
- Doganat
- Tatimet në pasuri
- Tatimi në trashëgimi dhe dhurata
- Tatimi në transferimin e patundshmërive
- Kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore

## II.1. Barra tatimore në vendet e BE

Barra tatimore në vendet e Bashkimit Europian është tejet e lartë sepse shumica e vendeve janë vende të zhvilluara dhe e kanë kaluar fazën e tranzicionit dhe thjesht mundohen me anë të politikave të brendshme ti shfrytëzojnë maksimalisht resurset e disponueshme në mënyrë që të arrijnë objektivat e tyre ekonomike dhe sociale.

**Grafiku 1: Barra tatimore si % e PBB-së, në vendet e Bashkimit Europian për vitin 2019**



**Burimi: Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik**

Te grafikoni i mësipërm është paraqitur barra tatimore në disa nga vendet e Unionit European duke filluar nga Austria e deri tek Lituania.


Mund të vërejmë që përqindja e barrës tatimore në raport me Produktin e Brendshëm Bruto varion nga 20% deri në 50% ku shtetet me barren tatimore më të lartë janë Danimarka me 46.34% , Franca me 45.04%, Belgjika me 42.92%, Suedia me 42.91%, Austria me 42.44%.

Ndërsa shtetet me barrën më të ulët tatimore janë Irlanda me 22.66 % , Zvcira me 28.53% dhe Lituania me 30.33%. Mesatarja e barrës tatimore në vendet anëtare të BE është 37.15 %.

## II.2. Barra tatimore në vendet e Ballkanit

Përsa i përket barrës tatimore, mund të vërejmë tek tabela e mëposhtme që vendet e Ballkanit krahasuar me vendet e BE kanë një mesatare më të ulët të barrës tatimore sepse në përgjithësi janë vende në tranzicion dhe ç’donjëri nga vendet tenton që të ketë politika nxitëse për thithjen e investimeve të huaja direkte krahasuar me vendet fqinje për të krijuar avantazhe konkurruese rajonale.

**Grafiku 2: Barra tatimore si % e PBB-së, në vendet e Ballkanit në vitin 2019**



**Burimi: kalkulim i autorit**

Nëse shohim tabelën e mësipërme mund të vërejmë që vendet me barrë më të lartë tatimore janë Greqia me 38.70 % të PBB, pastaj renditet Kroacia me 34.77 % të PBB-së, Bosnja dhe Hercegovina me 34.09%. Ndërsa vendet me barrë tatimore më të ulët janë Serbia me 19.56 % të PBB-së, Mali i zi me 23.69%, Kosova me 24.03% etj.

Mesatarja e barrës tatimore në vendet e Ballkanit është 28.71% dhe duke e krahasuar me mesataren e barrës tatimore në vendet e Bashkimit Europian mund të vërejmë se në vendet e Ballkanit barra tatimore është më e ulët për rreth 9% si raport proporcional me PBB-në ndërsa në raport me mesataren e BE është rreth 22% më e ulët.

### II.3. Normat tatimore në Ballkan

Kur flasim për normat tatimore, gjithëmonë kemi parasyshë që njëri ndër objektivat themelorë të ç'do qeverie është krijimi i një sistemi të tillë tatimorë që do të ishte sa më i favorshëm dhe sa më atraktiv për investitorët e huaj.

Çdo qeveri tenton që të krijojë avantazhe konkurruese gjatë hartimit të sistemit tatimorë në krahasim me vendet e rajonit, me qëllim të përmbushjes së objektivit të lartpërmendur. Tërheqja e investitorëve të huaj përmes një sistemi tatimorë me norma të ulta është më i theksuar në vendet në tranzicion sesa në vendet e zhvilluara sepse vendet e zhvilluara tentojnë që ç'do faktorë prodhimi që posedojnë ta shfrytëzojnë në mënyrë sa më efektive dhe efektive dhe tentojnë që ti mbajnë ndezur motorët e ekonomisë dhe nuk fokusohen tek ulja e normave tatimore për thithjen e investitorëve.

Ndërsa nga ana tjetër vendet në tranzicion , nga keqmenaxhimi me faktorët e brendshëm të prodhimit dhe mospërdorimi i tyre në mënyrë efektive dhe efektive bën që të mos kenë efektet dhe rezultatet e dëshiruara ekonomike dhe fokusin e tyre e zhvendosin tek krijimi i një klime sa më të favorshme për tërheqjen e investitorëve.

Prandaj edhe më poshtë do të shohim disa nga normat tatimore në vendet e Gadishullit Ballkanik siç janë tatimi në fitim, tatimi në të ardhura personale, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe norma e kontributeve sociale.

**Tabela 1: Normat tatimore në vendet e Ballkanit 2015-2020**

Nr	Shteti	Tatimi në fitim %	Tatimi personal %	TVSH %	N. e kontri. sociale %
1	Shqipëria	5, 15	13, 23	6, 20	27.7
2	Kosova	3, 9, 10	4, 8, 10	8, 18	10
3	Maqedonia e veriut	10	10	5, 18	28
4	Mali i Zi	9	9	7, 21	32.3
5	Serbia	15	10	10, 20	37.8
6	Bosnja & Hercegovina	10	10	17	41.5
7	Greqia	24	9, 22, 28, 36, 44	6, 13, 24	39.66
8	Bullgaria	10	10	0, 9, 20	25.4
9	Kroacia	10	36	5, 13, 25	37.2

**Burimi: Ministria e financave e shtetit përkatës**

Nëse vërejmë kolonën e tatimit në fitim, mund të vërejmë që kemi norma të ngjashme në të gjitha vendet duke filluar nga Shqipëria e deri në Kroaci ku normat e tatimit në fitim sillen nga 5% deri në 15% me përjashtim të Greqisë me 24% e cila renditet e para në rajon për normën më të lartë të tatim fitimit.

Në kolonën e dytë , mund të dallojmë që disa nga vendet e Ballkanit përdorin tatimin progresiv në të ardhura personale, edhe atë:

**Tabela 2: Vendet e ballkanit që përdorin sistemin tatimorë progresiv në të ardhura**

Nr.	Shteti	Intervali i pagës në valutën vendore	Periudha	Norma tatimore në %
1.	Shqipëria	0 deri 30.000 Lekë	Mujore	0
		30.001 deri 130.000 Lekë		13%
		mbi 130.000 Lekë		23%
2.	Kosova	0 deri 80 Euro	Mujore	0
		81 deri 250 Euro		4%
		251 deri 450 Euro		8%
		mbi 450 Euro		10%
3.	Greqia	0 deri 10.000 Euro	Vjetore	9%
		10.001 deri 20.000 Euro		22%
		20.001 deri 30.000 Euro		28%
		30.001 deri 40.000 Euro		36%
		mbi 40.000 Euro		44%

*Burimi: Ministria e financave e shtetit përkatës*

Tek kjo tabelë mund të shohim tre shtetet në vendet e Ballkanit të cilat përdorin tatimin progresiv në të ardhura që janë Shqipëria, Kosova dhe Greqia.

Edhe pse të tre vendet janë vende që nuk bëjnë pjesë në vendet e zhvilluara, por janë shtete në tranzicion dhe tatimi progresiv në të ardhura nuk është i preferuar për vendet e tilla për shkak se godet shtresën e lartë e cila supozohet që krijon vende të reja pune dhe ndihmon në zhvillimin ekonomik më të shpejtë, përsëri këto vende kanë bindje që progresioni tatimorë është më i përshtatshëm për ekonominë e tyre

Në kolonën e tretë është renditur tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), ku mund të shihet që pothuajse ç’do shtet përveq Bosnjës dhe Herzegovinës ka dy apo tre norma për TVSH-në.

- **Shqipëria** përdor dy norma për përlllogaritjen e TVSH-së, edhe atë normën standard 20% dhe normën e reduktuar prej 6% e cila përdoret për shërbimet e akomodimit, në agroturizëm, reklama dhe libra.

- **Kosova** përdor poashtu dy norma për përlllogritjen e TVSH-së, normën standarde 18% dhe normën e reduktuar 8% e cila aplikohet në furnizimin me ujë( me përjashtim të shisheve), shërbimeve të rrymës elektrike, drithërave dhe produkteve të tyre, vajrat e gatimit, produktet e përditshme, librat, teknologjia informative, paisjet spitalore, kafshët etj.
- **Magedonia veriore** poashtu përdor dy norma tatimore për TVSH-në , normën standard 18% dhe normën e reduktuar 5% për produktet ushqimore, furnizimi me ujë, teknologji informative, agrokulture, produktet shkollore, farmaceutike, paisjet spitalore, transport dhe akomodim etj.
- **Mali i Zi** përdor poashtu dy norma për TVSH-në, normën standarde prej 21% dhe normën e reduktuar prej 7% e cila aplikohet në produktet ushqyese, produktet farmaceutike dhe kompjuterët.
- **Sërbia** përdor normën standard 20% për përlllogaritjen e TVSH-së dhe normën e reduktuar 10% e cila aplikohet në produkte ushqimore, gazeta, produkte farmaceutike, transport public dhe shërbimet e ujit dhe rrymës elektrike.
- **Bosnja dhe Herzegovina** është i vetmi shtet në Ballkan i cili nuk aplikon normë të reduktuar të TVSH-së përveq normës standard 17%.
- **Greqia** është ndër vendet që përdor tre norma për TVSH-në edhe atë, normën standard prej 24% , normën e reduktuar prej 13% e cila aplikohet për ushqimin e freskët, për produktet për foshnje dhe akomodimet në hotele. Poashtu përdor edhe normën e reduktuar 6% për produktet farmaceutike.
- **Bullgaria** poashtu përdor dy norma për TVSH-në, normën standarde 20% dhe normën e reduktuar 9% e cila aplikohet për disa shërbime turistike siç janë hotele dhe restorante, produkte për foshnje, libra dhe paisjet sportive.
- **Kroacia** poashtu është ndër vendet që përdor tre norma për përlllogaritjen e TVSH-së, normën standarde 25% cila njëkohësisht është më e larta, normën e reduktuar 13% e cila aplikohet tek akomodimet, gazetatat, vajrat ushqimore, produktet për foshnje, furnizim me ujë, me energji elektrike, në agrokulturë, në produktet ushqyese të freskëta etj, dhe norma e reduktuar prej 5% aplikohet tek produktet e bukës dhe qumshtit, librat shkollorë, produkte farmaceutike dhe paisje spitalore etj

Në kolonën e fundit është renditur norma e kontributeve sociale në vendet e Ballkanit, ku mund të vërejmë se vendet me normën më të lartë janë Bosnja dhe Herzegovina me 41.5%, pastaj Greqia me 39.66% ndërsa me normë më të ulët janë Kosova me 10% dhe Bullgaria me 25.4% .

## II.4. Rritja ekonomike në vendet e Ballkanit

Siç e pamë edhe më sipër ç'do shtet ka norma tatimore të ndryshme dhe barra tatimore në një shtet është më e lartë, në një shtet është më e ulët. Prandaj më poshtë do të shohim trendin e rritjes ekonomike në vendet me barrë të lartë tatimore dhe me barrë të ulët tatimore.

**Tabela 3: Trendi i rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit gjatë periudhës 2015-2019**

Shteti	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatarja	Barra tat./Invest.
Shqipëria	2.2%	3.3%	3.8%	4.1%	2.2%	3.12%	3.44%
Kosova	4.1%	4.1%	4.2%	3.8%	4.2%	4.08%	
Maqedonia V.	3.9%	2.8%	1.1%	2.9%	3.2%	2.78%	
Mali i Zi	3.4%	2.9%	4.7%	5.1%	4.1%	4.04%	
Serbia	1.8%	3.3%	2.1%	4.5%	4.2%	3.18%	
Bosnja dhe H.	3.1%	3.1%	3.2%	3.7%	2.7%	3.16%	2.68%
Greqia	-0.4%	-0.2%	1.5%	1.9%	1.9%	0.94%	
Bullgaria	4.0%	3.8%	3.5%	3.1%	3.7%	3.62%	
Kroacia	2.4%	3.5%	3.4%	2.8%	2.9%	3%	

**Burimi: Banka botërore**

Në tabelën e mësipërme është paraqitur norma e rritjes vjetore të PBB në vendet e Ballkanit nga viti 2015 deri në vitin 2019. Rritjen më të lartë vjetore të PBB në rajon gjatë këtyre viteve e ka Mali i Zi në vitin 2019 me 5.1% , ndërsa rritjen negative apo më sakt kemi rënie të PBB në Greqi në vitin 2015 me -0.4%.

Gjatë vitit 2019 rritje më të madhe të PBB ka Kosova me 4.2% dhe Sërbia poashtu me 4.2%, pastaj Mali i Zi me 4.1% ndërsa rritjen më të ulët e ka Greqia me 1.9%.

Ndërsa nëse bazohemi në mesataren e pesë viteve të fundit, rritjen më të madhe poashtu e ka Kosova me 4.08%, pastaj Mali i Zi me 4.04%, në vendin e tretë renditet Bullgaria me 3.62%, Sërbia me 3.18%, Bosnja dhe Herzegovina me 3.16%, Shqipëria me 3.12%, Maqedonia Veriore me 2.78% dhe me rritjen mesatare më të ulët të PBB-së gjatë pesë viteve të fundit është Greqia me 0.94%.

Nëse e krahasojmë tabelën e barrës tatimore në vendet e Ballkanit me tabelën e mësipërme të rritjes ekonomike si % e PBB do të mund të shohim se si kanë performuar vendet me barrë të lartë tatimore në rritjen ekonomike edhe atë:



- Shqipëria bën pjesë tek vendet e Ballkanit me barrën ekonomike nën mesataren që është rreth 26.71% ndërsa ka rritjen ekonomike rreth 3.18%.
- Kosova poashtu bën pjesë në vendet me barrën ekonomike nën mesataren, rreth 24.03% dhe ka rritje ekonomike mesatare rreth 4.08%
- Maqedonia Veriore ka barrën tatimore rreth 26.60%, ka një rritje ekonomike mesatare prej 2.78%
- Sërbia ka barrën më të ulët tatimore në krahasim me vendet tjera të Ballkanit që është rreth 19.56% dhe ka rritje ekonomike mesatare prej 3.18%.
- Mali i zi ka barrën tatimore të dytën nga më të ultat në Ballkan , rreth 23.69% ndërsa rritjen ekonomike mesatare e ka të dytën nga më të lartat rreth 4.04%.
- Greqia ka barrën tatimore më të lartë në krahasim me vendet tjera të Ballkanit rreth 38.90% ndërsa ka rritjen mesatare më të ulët gjatë 5 viteve të fundit dhe poashtu gjatë dy viteve ka rënie ekonomike.
- Bullgaria ka barrën tatimore rreth 30.06% ndërsa ka rritje ekonomike mesatare rreth 3.62%.
- Kroacia ka barrën tatimore të dytën më të lartë në Ballkan, rreth 34.77% ndërsa ka rritje ekonomike mesatare rreth 3%.
- Bosnja dhe Herzegovina ka barrën tatimore rreth 34.06% ndërsa rritje ekonomike mesatare rreth 3.16%.

Nga kjo analizë krahasuese mund të kuptojmë që vendet me barrë më të lartë tatimore kanë pasur një rritje më të ulët ekonomike ndërsa vendet me barrë më të ulët tatimore kanë pasur një rritje më të lartë ekonomike.

Këtë mund ta shohim me rastin e Greqisë e cila ka një barrë tatimore shumë të lartë në krahasim me vendet tjera ndërsa një normë të rritjes ekonomike shumë të ulët ku në dy nga pesë vitet e fundit ka rënie ekonomike.

Poashtu këtë konkluzion mund ta mbështesim edhe me rastin e Kosovës dhe të Malit të zi të cilat kanë barrën tatimore nën mesataren dhe ndër më të ultat në rajon ndërsa kanë rritjen ekonomike më të lartë prej 4.08% Kosova dhe 4.04% Mali i zi.

Gjithashtu nëse analizojmë të gjithë vendet që kanë barrë tatimore nën mesataren siç janë Shqipëria, Kosova, Maqedonia Veriore, Sërbia dhe Mali i Zi dhe përlllogarisim mesataren e mesatareve të rritjes ekonomike të ç' do vendi gjatë 5 viteve të fundit do të shohim se kemi një

mesatare prej 3.44% të rritjes mesatare ekonomike të vendeve me barrë tatimore nën mesataren e Ballkanit.

Ndërsa nga ana tjetër , mesatarja e mesatareve të rritjes ekonomike të vendeve të Ballkanit me barrë tatimore mbi mesataren siç janë Kroacia, Bosnja dhe Herzegovina, Bullgaria dhe Greqia është 2.68%.

Por gjithësesi nuk mund të konstatojmë përfundimisht që barra tatimore ka një ndikim negativ në rritjen ekonomike sepse barra tatimore është një ndër dhjetra indikatorë që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi.

## II.5. Investimet e huaja në vendet me barrë të ndryshme tatimore

Investimet janë një ndër indikatorët që kanë efekt pozitiv në rritjen e Produktit të Brendshëm Bruto bashkë me Konsumin , Shpenzimet qeveritare dhe Eksportet. Poashtu njëkohësisht janë një ndër objektivat themelore të çdo qeverie dhe të ç'do vendi nga aspekti ekonomik.

Ç'do qeveri tenton që të ndërtoj sistem të atillë tatimorë i cili do të ishte atraktiv ndaj investitorëve dhe poashtu të ketë avantazhe konkurruese në krahasim me vendet e rajonit.

**Tabela 4 : Trendi i investimeve të huaja në vendet e Ballkanit gjatë periudhës 2015-2019**

Vendi / Viti	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatarja	Barra tat./Invest.
<b>Shqipëria</b>	8.7%	8.8%	7.9%	8%	7.9%	8.26%	6.73%
<b>Kosova</b>	5.3%	3.6%	4%	4%	3.8%	4.14%	
<b>Maqedonia V.</b>	2.9%	5.1%	3.4%	5.1%	3.8%	4.06%	
<b>Serbia</b>	5.9%	5.8%	6.6%	8%	8.3%	6.92%	
<b>Mali I Zi</b>	17.3%	5.2%	11.6%	8.8%	8.4%	10.26%	
<b>Bosnja dhe H.</b>	2.4%	1.9%	2.8%	2.9%	1.9%	2.38%	1.99%
<b>Bullgaria</b>	4.3%	2.7%	3.4%	1.8%	2.2%	2.88%	
<b>Greqia</b>	0.6%	1.4%	1.7%	1.8%	2.2%	1.54%	
<b>Kroacia</b>	0.1%	0.8%	0.9%	2%	1.9%	1.14%	

**Burimi: Banka botërore**

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur normat e investimeve në raport me PBB-në nga viti 2015 e deri në vitin 2019 për të gjitha vendet e Ballkanit.

Këtu mund të vërehet që normën më të lartë të investimeve të huaja në vitin 2019 e ka Mali i zi me 8.4%, me normën e dytë më të lartë është Serbia me 8.3%, pastaj Shqipëria me 7.9% ndërsa normën më të ulët të investimeve të huaja në vitin 2019 e ka Kroacia me 1.9% dhe Bosnja dhe Hercegovina me 1.9%.

Nëse analizojmë normën mesatare të investimeve të huaja gjatë pesë viteve të fundit , do të shohim se normën mesatare më të lartë e ka Mali i Zi me 10,26% , pastaj radhitet Shqipëria në vendin e dytë me 8.26%, ndërsa normën më të ulët e ka Kroacia me 1.14%.

Nëse e krahasojmë tabelën e barrës tatimore për vendet e Ballkanit me tabelën e investimeve, do të mund të shohim relacionin në mes të vendeve me barrë tatimore të lartë dhe normës së investimeve në ato vende edhe atë:

- Shqipëria ka barrë tatimore nën mesataren e vendeve të ballkanit, rreth 26.71% ndërsa ka normën e dytë më të lartë të mesatares së investimeve të huaja në raport me PBB-në rreth 8.26%.
- Kosova ka poashtu barrë tatimore nën mesataren e vendeve të Ballkanit dhe ka normë mesatare të investimeve të huaja prej 4.14% në raport me PBB-në.
- Maqedonia Veriore ka barrën tatimore rreth 26.60% ndërsa normën mesatare të investimeve të jashtme 4.06%
- Serbia ka barrën tatimore më të ulët në krahasim me vendet tjera rreth 19.56% ndërsa normën mesatare të investimeve të huaja e ka 6.92% apo të tretën më të lartë në Ballkan.
- Mali i Zi ka normën e dytë më të ulët të barrës tatimore me 22.69% ndërsa normën mesatare të investimeve të huaja e ka me 10.24% në raport me PBB-në që është më e larta në Ballkan.
- Greqia ka normën më të lartë të barrës tatimore prej 38.90% ndërsa normën mesatare të investimeve të huaja e ka rreth 1.54% në raport me PBB-në që është e dyta nga më të ultat në Ballkan.
- Bullgaria ka normë të barrës tatimore prej 30.06% ndërsa normë mesatare të investimeve të huaja prej 2.88%.
- Kroacia ka normën e dytë më të lartë të barrës tatimore në Ballkan prej 34.77% ndërsa normën mesatare të investimeve të huaja e ka rreth 1.14% që është më e ulta në Ballkan.

- Bosnja dhe Herzegovina është poashtu ndër vendet me barrë tatimore mbi mesataren e Ballkanit, rreth 34.06% dhe ka normë mesatare të investimeve të huaja prej 2.38% në raport me PBB-në.

Nëse e analizojmë vendet me barrë tatimore nën mesataren e vendeve të Ballkanit , mund të vërejmë që mesatarja e mesatares së vendeve që kanë barrë tatimore nën mesataren e Ballkanit, kanë një normë mesatare të investimeve prej 6.73% në raport me PBB-në.

Ndërsa mesatarja e mesatares së vendeve që kanë barrë tatimore më të lartë se mesatarja e Ballkanit kanë normë mesatare të investimeve prej 1.99% në raport me PBB-në.

Me këtë analizë mund të arrijmë në konkluzion që barra tatimore apo normat e larta tatimore japin efekte negative në investimet sepse nëse shohim vendet që kanë barrë të lartë tatimore si Greqia, Kroacia , Bullgaria dhe Bosnja dhe Herzegovina, të gjitha kanë norma të ulta të investimeve të huaja në vend por duhet pasur parasyshë se barra tatimore nuk është i vetmi faktorë që ndikon në tërheqjen e investimeve të huaja në një vend.

## **KAPITULLI III: SISTEMI TATIMORË NË SHQIPËRI GJATË PERIUDHËS 2007- 2012**

*A fine is a tax for doing something wrong. A tax is a fine for doing something right.*

**MARK TWAIN**

Shqipëria si një vend në tranzicion dhe kalimi nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë është shoqëruar poashtu edhe me ndryshime të mëdha mekanizmash dhe instrumentash të cilat do ta mundësonin krijimin e kushteve dhe klimës ekonomike për tregun e lirë si nga aspekti ligjorë dhe institucioal , ashtu edhe nga aspekti ekonomik dhe social me qëllim të shfrytëzimit maksimal të burimeve apo resurseve të ndyshme .

Poashtu njëkohësisht është tentuar të arrihet objektivi i rishpërndarjes efikase të PBB midis shtresave të ndryshme me qëllim të zvoglimit të pabarazisë, rritjen e standardit dhe mirëqenies etj.

Përsa i përket sistemit tatimorë , ka pasur ndryshime të shumta sepse gjithëmonë është tentuar që të krijohet një sistem i atillë tatimorë që është dëshmuar si i suksesshëm bazuar në eksperiencën e vendeve të zhvilluara por duke pasur parasyshë specifikat dhe veçoritë e struktures ekonomike dhe sociale të vendit, gjithëmonë janë hasur problemet e shpeshta siç

janë: mungesa e kulturës për pagesën e taksave, shkalla e lartë e informalitetit dhe zvoglimi i peshës së bujqësisë në PBB-në dhe punësimin.

Si rezultat i këtyre problemeve , nuk janë arritur efektet e synuara ekonomike dhe ka pasur reforma të shpeshta të sistemit tatimorë me qëllim përmbushjes së objektivave të vendosura siç janë nxitja e aktivitetit ekonomik, punësimin, zhvillimit ekonomik etj.

Një ndër vitet që mund të dallohet për nga reformat e sistemit tatimorë është viti 2007 i cili ishte viti në të cilin reformat e bëra ishin të fokusuar në uljen e barrës tatimore në krahasim me vendet e rajonit, politikë e cila ishte njëkohësisht nxitëse për zhvillimin ekonomik.

Reformat më të rëndësishme të politikës fiskale u miratuan ne paketën fiskale në korrik 2007 (International Monetary Fund , 2008), dhe mund të përmbliidhen si mëposhtë:

### **1. Aplikimi i tatimit të sheshtë**

- *Aplikim te sistemit taksës së sheshtë, prej 10% nga 1 korrik 2007, për tatimin mbi të ardhurat personale, duke eliminuar shkallët tatimore progresive, dhe duke mbajtur një nivel pragu përjashtues prej 10.000 lekë per pagat deri ne 30.000 lekë.*
- *Përgjysmim i normës së tatimit të fitimit, nga 20% ne 10%, nga 1 Janari 2008.*
- *Ndryshim i akcizës për disa mallra, duke i përafëruar me nivelin e akcizave të rajonit.*
- *Nje rritje në nivelin e taksave nacionale, duke konsideruar një rritje të taksës së importit të automjeteve të perdoruara, reduktim të taksës së ditëqëndrimit të automjeteve të huaja, taksës konsullore si dhe atyre portuale.*
- *Rritje në nivelin e taksave vendore, respektivisht taksa e pasurisë për ndërtesat te cilat ndodhen ne pronesi apo perdorim brenda territorreve të fshatrave turistike.*
- *Reduktim në taksat doganore, si pasojë e bërjes zero të taksës doganore për automjetet*

**2. Eliminimi i përjashtimeve** - Aplikimi i taksës së sheshtë, u shoqërua me një "paketë" të dytë e cila konsistonte në eliminimin e të gjitha përjashtimeve dhe lehtësirave që ishin akorduar më parë si në tatimin mbi fitim ashtu edhe për TVSH. Politika e shfuqizimit dhe minimizimit të përjashtimeve nga taksat, është një politikë, e cila është ndjekur nga pothuajse të gjitha vendet të cilat kanë aplikuar sistemin taksa e sheshtë. Heqja e këtyre perjashtimeve të dhëna me ligjet fiskale apo ligje të tjera të veçanta do të kenë impaktin e vet pozitiv në buxhetin e shtetit, duke siguruar të ardhura shtesë jo

vetëm nga eliminimi i tyre, por gjithashtu edhe nga përmirësimet në administrimin e burimeve të tjera, të cilat linin shteg për abuzime.

- 3. Politika lehtësuese fiskale** - Gjithashtu, në vëmendje ka qenë akordimi i lehtësive fiskale për dy sektorë të rëndësishëm: (i) energjinë dhe (ii) bujqësinë. Në këtë kuadër, subjektet të cilët ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5MW për burim, përfitojnë rimbursimin e akcizës së paguar, të lëndës djegëse të përdorur. Gjithashtu, janë shfrytëzuar disa elementë të mekanizmit të tatimit mbi vlerën e shtuar, me qëllim të ndikimit të tyre në një fushë sic është ajo e sistemit agrar. Nga 1 janar 2008, fermerët përfitojnë një kompensim prej 6% për të mbuluar pjesërisht një pjesë të TVSH-së së paguar më parë prej tyre e përfshirë në çmimin e blerjes së 7 mallrave e shërbimeve, që atyre u janë furnizuar për nevoja të veprimtarisë së tyre ekonomike

## **Struktura e të ardhurave tatimore**

Të ardhurat tatimore mund ti grupojmë në 2 lloje:

### **1) Tatimet indirekte**

Tatime indirekte apo të tërthorta janë ato tatime të cilat paguhen në momentin e shpenzimit apo blerjes së produkteve. Këto përfshijnë burimin kryesorë apo rreth 50% të të ardhurave totale në Shqipëri dhe kanë tendencë rritje. Këtu bëjnë pjesë:

- TVSH-tatimi mbi vlerën e shtuar cili përbën rreth 35% të totalit të të ardhurave buxhetore në vitin 2007
- Akcizat të cilat përbëjnë rreth 11% të të ardhurave buxhetore në vitin 2007
- Doganat përbëjnë rreth 3% të të ardhurave buxhetore dhe vazhdimisht kanë trend rënës për shkak të politikave të liberalizimit tregëtarë.

### **2) Tatimet direkte**

Tatimet direkte apo tatimet e drejtpërdrejta janë tatime të cilat paguhen në momentin e krijimit të të ardhurës. Ato përbëjnë rreth 25% të të ardhurave totale tatimore në vitin 2007 dhe tatimet kryesore që bëjnë pjesë në këtë lloj tatimesh janë:

- Tatimi mbi të ardhurat personale përbëjnë rreth 6.5%
- Tatim fitimi përbën rreth 9.2% nga të ardhurat totale tatimore

- Kontributet shoqërore dhe shëndetësore përbëjnë rreth 17% të të ardhurave tatimore

Efektet pozitive që priten nga këto reforma të sistemit tatimorë kanë të bëjnë me thjeshtësimin e administrimit të tatimit mbi të ardhurat personale si tatimi i sheshtë, ulja e normave tatimore e cila përveq efektit direkt në xhepat e popullatës, ka edhe efektin indirekt i që ka të bëjë me nxitjen e bizneseve dhe individëve të deklarojnë të ardhurat dhe aktivitetet e tyre duke e zvogluar informalitetin dhe në këtë mënyrë do të kemi rritjen e bazës tatimore dhe rritjen e të ardhurave buxhetore.

Poashtu ulja e normave tatimore jep efekte në nxitjen e investimeve sepse për shkak të uljes së barrës tatimore kemi një tendencë pozitive në vendimet për investim dhe zgjerim të bizneseve.

### III.1. Efektet e krizës globale në Shqipëri

Kriza globale financiare e vitit 2007 (Sufaj, 2015) u shfaq pas një stabiliteti ekonomik dhjetra vjeçarë dhe si shkak i një performancë joefektive e sistemit bankarë dhe sektorit financiarë.

Konsiderohet si kriza më e madhe financiare dhe ekonomike që nga kriza e viteve 1929-1933 e quajtur si depresioni i madh për shkak të pasojave të mëdha në ekonomitë e shteteve në qark botërorë.

Edhe pse Shqipëria paraprakisht kishte kaluar dy kriza të brendshme financiare, atë të vitit 1997, krizën e piramidave dhe krizën e vitit 2002 por kriza e vitit 2007 ishte krizë botërore dhe e panjohur për Shqipërinë dhe për shumicën e vendeve e cila erdhi nga SHBA si rezultat i problemeve me likuidetin në sistemin bankarë gjë që shkaktoi rënie të vlerës së patundshmërive e cila u përcoll me probleme të mëdha të institucioneve financiare.

Ndikimi nga kriza ishte i pashmangshëm edhe për Shqipërinë, pavarësisht se në fillimet krizës Shqipëria si një ndër vendet e pakta tregoi një stabilitet të theksuar dhe vazhdonte me rritjen ekonomike pozitive dhe progresive deri në vitin 2008 ku më pas filloi të ketë një rënie të rritjes ekonomike deri në nivelet më të ulëta.

Disa nga arsytet përse Shqipëria nuk u ndikua në mënyrë direkte nga kriza globale ishin:

- Si vend në zhvillim, edhe sistemi bankarë ishte i atillë pa shumë procedura të avancuara dhe të sofistikuara

- Mungesa e bursës
- Restriksionet e shumta bazuar në kualitetin dhe kuantitetin e investimeve
- Financimi i ulët nga tregu i jashtëm ndërkombëtarë për shkak të suficitit të likuiditetit monetarë vendorë
- Bankat Europiane që operojnë në Shqipëri nuk përdorin të njejtat rregullativa si në vendet Europiane dhe kjo i bëri të ndikohen më pak nga kriza

**Megjithatë efektet e krizës ishin të paevitueshme me kalimin e viteve prandaj edhe në analizat e mëposhtme duhet të kemi parasyshë që të gjitha indikatorët e analizuar gjatë periudhës së taksës së sheshtë sidomos pas vitit 2008 kanë qenë të ndikuar negativisht nga kriza globale efektet e së cilës ishin afatgjate.**

### III.2. Rritja ekonomike gjatë periudhës së tatimit të sheshtë

Procesi i kalimit nga ekonomia e centralizuar në një ekonomi tregu në Shqipëri ka qenë një proces mjaft kompleks. Debatet e ndryshme ekonomike, politike dhe sociale vazhdojnë të jenë rreth gjetjes së mënyrave apo strategjive të zhvillimit ekonomik të vendit.

Sipas shumë studiuesve, nëse një vend është i varfër, ka borxhe, ka pabarazi ekonomike dhe sociale, buxheti nuk mjafton për përmbushjen e kërkesave dhe nevojave, atëherë duhet të filloni të shtoni madhësinë e tortës që duhet të shpërndani, pra shtoni rritjen ekonomike që të keni më shumë para në dispozicion.

Edhe Shqipëria pas kalimit në ekonominë e tregut, sidomos pas vitit 1997 vijoi me rritje ekonomike të qëndrueshme dhe të lartë ku mund të shohim se nga viti 2002 deri në vitin 2007 kemi rritje vjetore rreth 5%.

***Tabela 5: Rritja ekonomike dhe norma e papunësisë në Shqipëri gjatë periudhës 2002-2012***

Viti	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
<b>Nor. e rrit. së PBB në %</b>	4.5%	5.5%	5.5%	5.5%	5.9%	6%	7.5%	3.4%	3,7%	2.5%	1.4%
<b>Nor. e papunësisë</b>	15.8%	15%	14.4%	14.1%	13.8%	16%	13.1%	13.7%	14.1%	13.5%	13.4%

**Burimi: Banka Botërore**



Në vitin 2007 me fillimin e aplikimit të taksës së sheshtë, rritja ekonomike dy vitet e para ishte në nivele të larta ku arriti deri në 7.5% në vitin 2008, ndërsa nga viti 2009 deri në vitin 2012 kapasur tendencë rënëse deri në 1.4% siç mund ta shohim edhe në tabelën e më lart por këtu mund të vërehet efekti i krizës globale ku sipas (BankofAlbania, 2009) gjatë kësaj periudhe u shfaq ngadalësimi i ekonomisë botërore, kryesisht kjo u vu re në bilancin e pagesave ku rënia e kërkesës së jashtme dhe rritja e papunësisë në vendet fqinje anëtare të Eurozonës, ndikoi në rënien e eksporteve dhe të ardhurave nga emigrantët dhe kjo zbuti kërkesën e brendshme për konsum dhe poashtu një efekt negativ dha edhe ulja e kreditimit të brendshëm.

Domethënë deri në vitin 2008, kemi një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe siç mund të shohim në tabelën më lart, kemi edhe një rënie të normës së papunësisë deri në 13.1% gjë që lidhet me ligjin e Okunit por me një efekt të zbehtë sepse kemi rënie të ulët të papunësisë krahasuar me rritjen e lartë. Pas vitit 2009, mund të shohim që kemi një rritje ekonomike vjetore në nivele më të ulëta ndërsa norma e papunësisë fillon të ketë rritje gjë që na lë të kuptojmë që kjo rritje nuk është reale por e mbështetur në inflacion dhe borxh publik sepse në vitin 2009 kemi raport të rritjes së GDP me rritjen e Borxhit publik rreth 70% që dmth borxhi i marrë është orientuar në shpenzime joproduktive të cilat nuk kanë gjeneruar rritje ekonomike.

Përsa i përket efektit që ka dhënë rritja ekonomike në papunësi, sipas ( Klapper, etj., 2020) një ndër shkaqet pse ky efekt është i zbehtë përveq efekteve të krizës është edhe sepse rritja ekonomike është mbështetur në remitencat, në konsumin dhe në importet. Kjo rritje ka qenë më shumë rritje sasiore sepse shumica e vendeve të reja të punës pas vitit 2000 kanë qenë vende pune në aktivitete shërbyese pa standarde të larta dhe cilësi siç janë call center-at dhe bizneset e këtilla nuk mund të presim që ti japin një rritje ekonomike të lartë dhe afatgjate vendit.

### III.3. Të ardhurat tatimore të R.Shqipërisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë

Shumica e vendeve në tranzicion, përballen me problemin e evazionit fiskal apo më sakt me shmangien e pagesës së tatimeve. Shqipëria poashtu përballlet me një problem të tillë dhe një ndër objektivat e ç'do qeverie dhe të ç'do reforme të sistemit tatimorë ka qenë edhe ulja e të ashtuquajturës ekonomi e zezë apo ulje të evazionit fiskal.

Debati në lidhje me atë se sa ndikojnë taksat efektive në rritjen ekonomike vazhdon, sepse studime të ndryshme kanë dhënë rezultate të ndryshme ku sipas (Maganya, 2011) normat e ulëta tatimore kanë një efekt pozitiv në performancën ekonomike të një vendi.

Gjatë ndryshimit të sistemit tatimorë në vitin 2007, Shqipëria u bë ndër vendet me barrën më të ulët tatimore në rajon dhe kjo pati një efekt pozitiv në rritjen e të ardhurave totale në buxhet siç mund ta shohim në tabelën e mëposhtme.

**Grafiku 3 Të ardhurat tatimore gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012** në milionë lekë



**Burimi: Banka Botërore**

Nga viti 2007 e deri në vitin 2010 , kemi rritje permanente të të ardhurave tatimore ku në vitin 2010 mund të shohim që të ardhurat tatimore arrijnë kulmin gjatë këtyre pesë viteve ku arrijnë në 328,729 milion lekë ndërsa pas vitit 2010 ato fillojnë të bien (efekti i krizës) dhe në vitin 2012 të ardhurat tatimore janë 325,306 milionë lek.

Por duke pasur parasyshë që të ardhurat tatimore totale janë të dominuara nga tatimet e konsumit siç janë TVSh-ja dhe akcizat dhe ato nuk janë të ndikuara direkt nga taksa e sheshtë, në tabelën e mësipërme janë paraqitur të ardhurat tatimore nga tatimi i të ardhurave personale nga e cila mund të vërejmë që nga viti 2007 deri në vitin 2010 kemi poashtu një rritje të vazhdueshme të të ardhurave tatimore nga ky lloj i tatimit. Viti 2010 është viti me të ardhura më të larta nga ky tatim të cilat arrijnë në 33,862 milion lekë, dhe gjat dy viteve në vazhdim kemi rënie të të ardhurave nga tatimi personal deri në 29,754 milion lekë.

Pra mund të shohim që taksa e sheshtë ka dhënë efekt pozitiv si në rritjen e të ardhurave tatimore totale ashtu edhe në rritjen e të ardhurave tatimore nga tatimi në të ardhura personale dhe një ndër shkaqet është që edhe evazioni të jetë më i ulët në tatime më të ulta.

### III.4 Investimet e huaja gjatë periudhës tatimit të sheshtë


Me reformat e sistemit tatimorë dhe vendosjen e taksës së sheshtë në vitin 2007, Shqipëria u bë një vend atraktiv për investitorët e huaj dhe këtë mund ta vërejmë me efektin pozitiv në investime që ka dhënë kjo taksë gjatë periudhës së aplikimit të sajë nga viti 2007 deri në vitin 2012.

Për investitorët e huaj, Shqipëria ka në dispozicion resurse natyrore të pashfrytëzuara, rregulla të thjeshta për tregëtinë dhe IHD, afërsinë me tregjet e europës, kosto e ulët e punës, materiale të lëndëve të para me çmime konkurruese, pozita gjeografike etj.

Gjatë vitit 2007, kemi rreth 647 milion dollarë investime të jashtme apo rreth 6.1% e GDP-së ndërsa gjatë vitit 2008 mund të shohim se kemi rritje të investimeve ku arrijnë deri në rreth 881 milionë dollarë apo 9.7% e GDP-së.

Viti 2009 është viti me investimet më të larta gjatë këtyre viteve ku investimet e jashtme në Shqipëri gjatë këtij viti arritën në 950 milion dollarë apo rreth 11.2% e GDP-së.

**Grafiku 4: Investimet e huaja në Shqipëri gjatë periudhës së tatimit të sheshtë**



**Burimi: Banka Botërore**

Gjatë vitit 2010 kemi një rritje të investimeve në rreth 1,043 milionë dollar apo 9.1% e GDP-së.

Gjatë vitit 2011 mund të shohim që kemi poashtu një rënie të investimeve të jashtme deri në 846 milionë dollar apo rreth 8.1% e GDP-së siç e përmendëm edhe më sipër këtu vjen në shprehje efekti i krizës globale.

Dhe gjatë vitit 2012 kemi poashtu një rënie të investimeve deri në 834 milionë dollarë apo 7.5% e GDP-së.

Nëse krahasojmë vitin e parë të fillimit të zbatimit të taksës së sheshtë që është viti 2007 me vitin e fundit të zbatimit të kësaj takse , do të shohim se kemi një rritje prej rreth 29% të investimeve të huaja në Shqipëri. Ndërsa nëse i analizojmë të gjashtë vitet e zbatimit të taksës së sheshtë do të shohim se mesatarja e investimeve të huaja në Shqipëri gjatë këtyre 6 viteve është 866 milionë dollarë.

### III.5 Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit të sheshtë


Borxhi publik është një indikatorë i rëndësishëm i cili është prezent në të gjitha ekonomitë e vendeve botërore duke filluar nga vendet më të zhvilluara e deri tek vendet në zhvillim.

Një nga arsytet se përse qeveritë marrin hua është sepse mjetet financiare jovetakane, të cilat janë përtej kapacitetit vjetor buxhetor të një vendi janë një burim i nxitjes dhe zhvillimit ekonomik dhe ndihmon që ekonomitë të ecin përpara me ritme më të shpejta por nga ana tjetër rritja dhe akumulimi i vazhdueshëm i borxhit shoqërohet edhe me rreziqe të ndryshme siç janë rritja e normave të interesit, ulja e investimeve dhe e konsumit e cila rezulton me një ngadalsim të aktivitetit ekonomik.

Sipas (Cecchetti , Mohanty , & Zam, 2011) kufiri nga i cili borxhi fillon të ketë ndikim negativ dhe fillon që të jetë një barrë për PBB-në sillet diku tek rreth 85% e PBB-së por këtu mund të konsiderohet si pika kritike prandaj kjo nuk do të thotë që vendet duhet të tentojnë që të stabilizojnë borxhin në këtë nivel por ato duhet të tentojnë që të mos i afrohen kësaj pike sepse nuk dihet asnjëherë kur mund të ndodhë një shok ekonomik prandaj ato duhet që sa më shpejt ti adresojnë problemet fiskale në mënyrë që të stabilizojnë borxhin.

Në rastin e Shqipërisë mund të shohim se gjatë viteve 2007-2012 kemi një rritje të vazhdueshme të borxhit publik ku në vitin 2007 borxhi është rreth 517,031 milionë lek apo rreth 53.48% e PBB-së.

**Grafiku 5: Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012**



**Burimi: Ministria e financave, Borxhi**

Pas fillimit të aplikimit të taksës së sheshtë , mund të vërejmë që gjatë 6 viteve të zbatimit , kemi një rritje të vazhdueshme të borxhit publik ku në vitin 2008 borxhi arrin në 595,883 milion lekë apo rreth 54.77% e PBB.

Në vitin 2009 dhe në vitin 2010 kemi përsëri rritje të borxhit në 715,371 milion lekë por në raport me PBB-në kemi rënie në 57.71% sepse kemi njëkohësisht rritje të PBB-së. Në vitin 2011 borxhi arrin në 772,732 milion lekë apo 59.40% e PBB-së. Ndërsa në vitin 2012 borxhi arrin në 828,265 milion lekë apo 62.12% e PBB-së.

Nëse e krahasojmë vitin 2007 kur ishte fillimi i zbatimit të taksës së sheshtë me vitin 2012 mund të shohim se kemi rritje të borxhit publik për rreth 60% nga 517,031 milionë lekë në 828,265 milionë lekë.

**Tabela 6: Raporti në mes të rritjes së borxhit dhe rritjes së GDP gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012** në milionë lek

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012
GDP	965,527	1,080,676	1,143,937	1,239,645	1,300,624	1,332,810
Rritja	92,729	115,149	63,261	95,708	60,979	32,186
Borxhi Publik	517,031	595,883	682,546	715,371	772,732	828,265
Rritja	22,447	78,852	86,663	32,825	57,361	55,533
Rrit. e GDP/Rrit. e borxhit	413%	140%	72%	291%	106%	57%

**Burimi: Ministria e Financave, Banka Botërore**


Poashtu në tabelën e mësipërme mund të shohim që raporti në mes të rritjes së PBB-së dhe borxhit nuk është i kënaqshëm sepse përveç vitit 2007 dhe 2010, rritja ekonomike është e inicuar kryesisht nga borxhi ku në vitet 2009 dhe 2012 mund të shohim që kemi një orientim joproduktiv të shpenzimeve sepse siç mund të shohim rreth 72% e borxhit është përkëthyer në rritje ekonomike në vitin 2009 ndërsa në vitin 2012 rreth 57%.

### III.6. Konsumi i përgjithshëm gjatë periudhës së tatimit të sheshtë

Konsumi është një ndër indikatorët me ndikim më të madh në Prodhimin e Brendshëm Bruto si në vendet me ekonomi të zhvilluar, ashtu edhe në vendet në zhvillim edhe pse tek ky grup i vendeve, pjesmarrja e konsumit në strukturën e PBB-së është më e theksuar.

Në rastin e Shqipërisë në tabelën e mëposhtme mund të vërehet pjesmarrja e lartë dhe dominuese e konsumit në Prodhimin e Brendshëm Bruto duke filluar nga viti 2007 ku është rreth 92.2%.

**Grafiku 6: Konsumi gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012**



**Burimi: Banka Botërore**

Në vitin 2008 edhe pse kemi rritje të konsumit dhe njëkohësisht të PBB-së, përsëri edhe pjesmarrja e konsumit në GDP rritet në 93.5%

Nga viti 2009 mund të vërejmë që kemi një rritje të konsumit dhe një rënie të vazhdueshme të pjesmarrjes së tij në GDP me 91.9%, pastaj në vitin 2010 me 89.3%, në vitin 2011 poashtu me 89.3% ndërsa në vitin 2012 me 88.8%.

Nëse e krahasojmë vitin e parë të aplikimit të taksës së sheshtë që është viti 2007 me vitin 2012, mund të vërejmë që kemi një rritje të konsumit me rreth 10.8%, nga 9,440 milion dollarë në 10,834 milionë dollarë ndërsa nga ana tjetër mund të vërejmë uljen e vazhdueshme të pjesmarrjes së konsumit në PBB nga 92.2% në vitin 2007 në 88.8% që në vitin 2012 apo rreth 3.6%.

Kjo ka ndodhur si rezultat i rritjes së pjesmarrjes së indikatorëve tjerë në strukturën e PBB-së siç janë investimet, shpenzimet qeveritare dhe eksportet që kanë ndikim pozitiv në rritjen e PBB-së.

## **KAPITULLI IV: SISTEMI TATIMORË NË SHQIPËRI NGA VITI 2013-2020**

"The purpose of a tax cut is to leave more money where it belongs: in the hands of the working men and working women who earned it in the first place"

**Bob Dole**

Pas zgjedhjeve parlamentare në vitin 2013 në Shqipëri, u bë kalimi i pushtetit nga Partia Demokratike tek Partia Socialiste.

Filozofia politike dhe ekonomike e të dy partive ishte e ndryshme ku Partia Demokratike gjatë viteve të qeverisjes së saj, nga viti 2007 deri në vitin 2012 mbështeste taksën e sheshtë dhe kishte bindjen se njerëzit udhëhiqen nga nxitjet dhe një taksë progresive zvoglon nxitjen e njerëzve për të punuar më shumë sepse duhet të paguajnë më shumë tatime ndërsa nga ana tjetër marrin të njejtat shërbime publike me njerëzit që paguajnë më pak ose nuk paguajnë fare.

Partia Socialiste nga ana tjetër , mbështet taksën progresive dhe mbështetet në qëndrimin që një taksë progresive fokusohet në barazinë sepse një normë tatimore prej 10% në një pagë 30.000 lek dhe e njejtja normë 10% e aplikuar në pagën prej 300.000 lek nuk është e barabartë sepse tek paga e ulët , ky tatim zvoglon mirëqenien e individit ndërsa tek paga e lartë nuk ndikon në mirëqenie por ndikon në uljen e kursimeve.

Sipas (Diamond & Saez, 2011) normat e taksës marginale duhet të jenë më të ulta për shtresën e mesme dhe të ulët dhe më të larta për grupet me të ardhura më të larta sepse sipas tij ky është modeli që i afrohet më tepër sistemit optimal të taksimit duke rritur mirëqenien ekonomike dhe sociale.

Poashtu taksa progresive ka ndikim pozitiv në rritjen e numrit të personave me të ardhura mesatare apo më sakt të shtresës së mesme meqenëse tek vendet në tranzicion, poashtu edhe në Shqipëri, kjo shtresë është e vogël.

Pas hyrjes në qeveri të kësaj partie në vitin 2013 , një ndër reformat e para tatimore që u bë ishte heqja e taksës së sheshtë në të ardhura personale prej 10% dhe vendosja e taksës progresive me 3 shkallë tatimimi edhe atë:

- Për pagat prej 0 - 30.000 lek norma tatimore është 0%
- Për pagat nga 30.001 – 130.000 lek norma tatimore është 13%
- Dhe për pagat mbi 130.000 lek norma tatimore është 23%

#### IV.1. Rritja ekonomike gjatë periudhës së tatimit progresiv


Ekzistojnë debate të shumëta në lidhje me raportin midis taksave marginale dhe rritjes ekonomike ku sipas shumë ekonomistëve, rritja e tatimeve në të ardhura automatikisht zvoglon paranë në treg , e cila rezulton në ulje të kërkesës agregate dhe ulje të konsumit dhe si rezultat i kësaj në këndvështrim afatshkurtër kemi rënie të rritjes ekonomike.

Nga ana tjetër shumë autorë si (Hungerfort, 2012) dhe (Gravelle & Marples, 2014) kanë ardhur në përfundim që rritja e normave të taksave marginale nuk ka efekt në rritjen ekonomike.

Përsa i përket trendit të rritjes ekonomike gjatë periudhës së qeverisë majtiste e cila është mbështetëse e fortë e taksës progresive, mund të vërejmë që kemi një rritje të konsiderushme të rritjes ekonomike.

#### ***Grafiku 7: Rritja ekonomike gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019***





**Burimi: Banka Botërore**

Në vitin 2013 mund të vërejmë që kemi një rritje minimale prej 1% krahasuar me vitet në vijim, në vitin 2014 kemi një rritje prej 1.8%, deri në vitin 2018 kemi rritje graduale të vazhdueshme ku në këtë vit arrihet norma më e lartë e rritjes ekonomike prej 4.1% dhe në vitin 2019 kemi rritje ekonomike prej 2.2%.

Poashtu sipas ( Klapper, etj., 2020) një ndër shkaqet që rritja ekonomike në vitin 2014-2016 nuk vazhdon me ritme të shpejta është sepse kemi rënie të produktivitetit të punës pasi vetëm 20% e vendeve të reja të punës zihen nga persona me arsim të lartë dhe të kualifikuar për vendin përkatës.

Sipas (INSTAT, 2019) kjo rënie e rritjes ekonomike nga 4.1% në vitin 2018 në 2.2% në vitin 2019, vjen si pasojë e dy shkaqeve kryesore. Njëri ndër shkaqet e kësaj rënie të rritjes ekonomike është sepse për shkak të kushteve jo të favorshme klimatike, apo më sakt nga thatësia e tepërt, Shqipëria në 6 mujorshin e parë të 2019-ës ka prodhuar 3 herë me pak energji elektrike nga hidrocentralet publike dhe private në total krahasuar me vitin 2018 dhe për këtë arsye është detyruar të importojë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike ndryshe nga vitet e tjera kur tentohej eksportimi i energjisë elektrike, gjë e cila dha efekt negativ në ekonominë shqipëtare. Edhe projektet e mëdha të energjisë të cilat ishin të financuara nga IHD ishin në prag të përfundimit dhe konsumi u bë shtytësi kryesorë i ekonomisë.

Poashtu si shkak tjetër për rënien e rritjes ekonomike është edhe tërmeti i nëntorit të vitit 2019, ku Shqipëria u përball me këtë fatkeqësi natyrore dëmet e të cilit ishin shumë të mëdha dhe kjo poashtu pati një efekt negativ në ekonominë e Shqipërisë.

Nëse krahasojmë rritjen ekonomike dhe normën e papunësisë gjatë periudhës së njejtë kur aplikohet taksa progresive, mund të kuptojmë që ekziston një lidhje logjike duke u bazuar në ligjin e Okunit i cili thotë nëse kemi rënie ekonomike prej 2%, do të rezultojë me rritje të normës së papunësisë me 1%. Në rastin e Shqipërisë kemi rritje ekonomike graduale prej 2% deri në 4 % dhe poashtu kemi rënie të normës së papunësisë prej 1 deri në 2% ç’do vit.


## IV.2. Të ardhurat tatimore gjatë periudhës së tatimit progresiv

Gjatë periudhës së zbatimit të taksës progresive, nga viti 2013 deri në vitin 2019 mund të shohim që kemi një rritje të të ardhurave tatimore me ritme më të shpejta.

Viti 2013 është i vetmi vit që ka efekt negativ në të ardhurat tatimore totale me 6.5% dhe poashtu në të ardhurat nga tatimi personal 4.51%.

### **Grafiku 8 Të ardhurat tatimore dhe nga T.P gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**

*në milionë lekë*



**Burimi: Ministria e financave, Buxheti**

Viti 2014 është viti me rritjen vjetore më të lartë tek të ardhurat tatimore totale me 14% ndërsa tek të ardhurat nga tatimi personal kemi rritje prej 0.3%.

Kjo rritje graduale vazhdon deri në vitin 2019 ku të ardhurat tatimore totale janë rritur nga 293,910 milion lekë në vitin 2013 në 447,334 milion lekë në vitin 2019 apo një rritje prej 52% për 7 vite.


Ndërsa tek të ardhurat nga tatimi personal kemi gjithashtu një rritje të vazhdueshme nga viti 2013 që ishin 28,412 milion lekë deri në vitin 2019 ku arritën në 41,900 milion lekë apo një rritje prej 47,47% për 7 vite.

### IV.3 Investimet gjatë periudhës së tatimit progresiv

Investimet e jashtme janë një ndër objektivat themelore të ç'do qeverie , pavarësisht pikpamjeve të partive në pushtet.

Në rastin e Shqipërisë pas aplikimit të taksës progresive në vitin 2013, mund të shohim se kemi një rritje të investimeve të jashtme në krahasim me vitin 2012 kur ishte taksa e sheshtë nga 7.5% në 9.8%.

**Grafiku 9: Investimet gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**



**Burimi: Banka Botërore**

Investimet e huaja direkte në Shqipëri janë kryesisht në sektorin e Energjisë elektrike, gazit dhe furnizimi me ujë dhe poashtu në të ashtuquajturën industria nxjerrëse.

Në vitin 2014 vlera totale e investimeve arrin në 1,078 milionë dollarë dhe si investime më të rëndësishme të atij viti janë privatizimi i katër hidrocentraleve nga kompani turke dhe blerja e aksioneve të një kompanie për rafinim të naftës nga një kompani e Azerbaxhanit.

Në vitin 2015 kemi rënie të investimeve në 910 milionë dollarë por në raport me PBB është e njejtë 8.7%.

Në vitin 2016 kemi investimin për realizimin e gazsjellësit (TAP), i cili përbënte rreth 40% të investimeve totale të atij viti. Gjithashtu investime tjera të rëndësishme kemi në fushën e naftnxjerrjes nga investitori kanadez në shumën 575 milionë dollarë ku investimet totale këtë vit arrijnë në 1,037 milion dollarë.

Në vitin 2017 kemi rritje të investimeve të huaja në 1,128 milionë dollarë apo 7.9% e PBB-së.

Në vitin 2018 kemi përsëri rritje të investimeve të huaja në 1,208 milionë dollarë apo 8% e PBB-së ndërsa në vitin 2019 kemi rënie të investimeve të huaja në 1,161 milionë dollarë apo 7.9% e PBB-së.

Mund të vërejmë që gjatë aplikimit të taksës progresive, investimet mesatare nga viti 2013 deri në vitin 2019 janë 1,106 milionë dollarë dhe mesatarja e përqindjes së pjesmarrjes së investimeve të jashtme në Prodhimin e Brendshëm Bruto është 8.54%.


#### IV.4 Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit progresiv

Edhe pse preferohet që borxhi publik të mos e tejkalojë 60% të PBB-së, sepse paraqet një rrezik dhe pasiguri të lartë siç ndodhi rasti i Greqisë, përsëri këtë kriter nuk e respektojnë edhe shumica e vendeve anëtare të BE-së duke filluar nga Portugalia, Greqia, Italia, Spanja, Franca, Gjermania etj.

Në Shqipëri borxhi publik gjatë tatimit progresiv ka pësuar një rritje të vazhdueshme nga viti 2013 deri në vitin 2019 por krahasuar me PBB-në mund të shohim që kemi një stabilitet të borxhit.

Në vitin e parë të zbatimit të taksës progresive, në vitin 2013 borxhi publik është rreth 885,083 milionë lekë apo rreth 65.56% e PBB-së.

**Grafiku 10: Borxhi publik gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**



**Burimi: Ministria e Financave, Borxhi**

Gjatë vitit 2014 kemi një rritje të borxhit në 977,957 milionë lek dhe gjithashtu një rritje në raport me PBB në 72.66%.

Kjo rritje e borxhit në mbi 70% u pasqyrua pas vitit 2013 si pasojë e borxheve të marra nga qeveria e kaluar dhe poashtu si pasojë e detyrimeve të prapambetura të shtetit ndaj privatëve të cilat arrinin deri në 600 milionë dollarë.

Në vitin 2015 kemi një rritje të borxhit në 1,043,212 milionë lek dhe gjithashtu këtë vit është niveli më i lartë i borxhit në raport me PBB krahasuar me vitet tjera.

Viti 2016 gjithashtu vazhdon me një rritje të ulët të borxhit në 1,066,500 milionë lekë apo 71.01% e PBB-së.

Në vitin 2017 kemi poashtu një rritje të ulët të borxhit deri në 1,087,342 milionë lekë por kemi ulje në raport me PBB-në në 70.09% sepse kemi rritje më të lartë të PBB-së në krahasim me borxhin.

Në vitin 2018 kemi rritje të borxhit në 1,106,285 milionë lekë por kemi përsëri ulje në raport me PBB-në në 67.85% për shkak të rritjes më të lartë të PBB-së në krahasim me rritjen e borxhit.

Dhe në vitin 2019 kemi përsëri rritje të borxhit në 1,112,626 milionë lekë dhe ulje të raport me PBB në 65.84%.

Nëse analizojmë vitin e parë të zbatimit të taksës progresive, vitin 2013 me vitin 2019, mund të vërejmë që kemi një rritje të borxhit nga 885,083 milionë lekë në 1,112,626 milionë lekë apo një rritje prej rreth 25%. Domethënë kemi një rritje mesatare vjetore prej 3.6%.

Ndërsa nëse vërejmë raportin e borxhit me PBB-në në vitin 2013 dhe në vitin 2019, mund të vërejmë që nuk ka një diferencë të theksuar sepse me rritjen e borxhit, kemi edhe rritje të PBB-së njëkohësisht.

**Tabela 7: Raporti në mes të rritjes së Borxhit Publik dhe rritjes së GDP gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019** *në milionë lekë*

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
GDP	1,350,052	1,395,304	1,434,306	1,472,479	1,550,645	1,635,714	1,678,430
Rritja	104,288	45,252	39,002	38,173	78,166	85,069	42,716
Borxhi Publik	885,083	977,957	1,043,212	1,066,500	1,087,342	1,106,285	1,112,626
Rritja	56,818	92,874	65,255	23,288	20,842	18,943	6,341
Rrit. e GDP/Rrit. e borxhit	183%	48.72%	59.76%	163.92%	375.04%	449.08%	673.65%

**Burimi: Ministria e Financave, Banka Botërore**

Nëse analizojmë borxhin e marrë dhe e krahasojmë me GDP-në, mund të shohim që raporti i ndryshimit të borxhit me ndryshimin e GDP-së është mjaft pozitiv përveç viteve 2014 dhe 2015 ku rreth 50% e borxhit të marrë konvertohet në aktivitet ekonomik ndërsa vitet tjera sidomos vitet e fundit kemi një rritje të aktivitetit ekonomik krahasuar me borxhin deri në 670% siç mund ta shohim edhe në tabelën e mësipërme.


Me këtë mund të kuptojmë që mjetet që janë marrë borxh janë orientuar në bazë të prioriteteve dhe këtë mund ta bazojmë në përkthimin e borxhit në aktivitet ekonomik siç quhet ndryshe edhe Produktiviteti Margjinal i Borxhit Publik. (Shano, 2018)

#### IV.5 Konsumi i përgjithshëm gjatë periudhës së tatimit progresiv

Konsumi si indikatorë i rëndësishëm ekonomik dhe dominues në pjesmarrjen e tij në Prodhimin e Brendshëm Bruto është i lidhur ngushtë me mirëqenien ekonomike dhe me politikën e taksave sepse sa më shumë para tu mbeten në dispozicion konsumatorëve pas tatimit, aq më i madh do të jetë konsumi dhe mirëqenia e tyre.

Në rastin e Shqipërisë, mund të shohim se konsumi ka pësuar rritje të vazhdueshme gjatë periudhës së taksës progresive si në tabelën e mëposhtme.

**Grafiku 11: Konsumi gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**



**Burimi: Banka Botërore**

Konsumi në vitin 2013 ka arritur në 11,047 milionë dollarë apo 91.1% e PBB-së. Një vit më pas në vitin 2014 kemi përsëri një rritje të konsumit në 11,405 milionë dollarë apo 92.2% e PBB-së. Viti 2015 vazhdon me një rritje më të ulët të konsumit ku arrin në 11,508 milionë dollarë por në raport me PBB-në kemi ulje deri në 91.8%. Në vitin 2016 kemi rritje të konsumit të përgjithshëm në 11,789 milionë dollarë apo 92.2% e PBB-së.

Viti 2017 dhe 2018 vazhdojnë përsëri me rritje të konsumit deri në 12,087 dhe 12,449 milionë dollarë por kemi ulje të pjesmarrjes së konsumit në PBB me 91.1% dhe 90.2% sepse kemi rritje më të madhe të PBB-së dhe të indikatorëve të tjerë. Dhe viti 2019 vazhdon gjithashtu me rritje të konsumit të përgjithshëm deri në 12,869 milionë dollarë apo 91.8%.

Nëse e krahasojmë vitin e parë të aplikimit të tatimit të sheshtë, vitin 2013 me vitin 2019, mund të vërejmë që kemi një rritje të konsumit të përgjithshëm nga 11,047 milionë dollarë në 12,869 milionë dollarë apo një rritje prej 16.4%. Ndërsa pjesa e përkjet pjesmarrjes së konsumit në Prodhimin e Brendshëm Bruto, kemi një rritje të vogël prej 0.7%.

## IV.6 KRAHASIMI NË MES TË DY PERIUDHAVE TË DY SISTEMIVE TATIMORE NGA ASPEKTI EKONOMIK

### IV.6.1 Krahasimi i rritjes ekonomike në mes të periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Mesatarja
<b>Norma e rrit. ekonomike në %</b>	6%	7.5%	3.4%	3,7%	2.5%	1.4%	4.08%

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatarja
<b>Norma e rrit. ekonomike në %</b>	1%	1.8%	2.2%	3.3%	3.8%	4.1%	2.2%	2.62%

*Burimi: Banka Botërore*

Rritja ekonomike është një indikator që gjatë periudhës së taksës së sheshtë ka arritur në nivelet më të larta të sajë gjatë dy dekadave të fundit.

Kulmi i rritjes ekonomike gjatë periudhës së taksës së sheshtë është në vitin 2008 me rreth 7.5% por vazhdimësia vijon me një rënie të konsiderueshme të rritjes ekonomike deri në 1.4% në vitin 2012.

Mesatarja e rritjes ekonomike gjatë periudhës së aplikimit të taksës së sheshtë nga viti 2007 deri në vitin 2012 është rreth 4.08 %.

Nga ana tjetër gjatë aplikimit të taksës progresive nga viti 2013, mund të shohim një rritje të vazhdueshme të rritjes ekonomike nga 1% në vitin 2013 deri në 4.1% në vitin 2018 dhe 2.2% në vitin 2019.

Mesatarja e normës së rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe është rreth 2.62 % dhe një anë pozitive e kësaj periudhe ndryshe nga periudha paraprake është trendi pozitiv i rritjes ekonomike.

Duket qartë që rritja ekonomike gjatë periudhës së taksës së sheshtë ka qenë në nivele më të larta me një mesatare prej 4.08% krahasuar me mesataren e periudhës së taksës progresive prej 2.62% por ka filluar me një vijueshmëri të një rritje ekonomike të lartë dhe të qëndrueshme dhe vazhdon me një trend rënës, sidomos në vitet e fundit ndërsa gjatë periudhës së taksës progresive, vitet e para janë me rritje të ulët ekonomike por vazhdimësia në vitet në vijim tregon një efekt pozitiv dhe rritës të ekonomisë.

#### IV.6.2. Krahasimi i të ardhurave tatimore në mes të periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

në milionë lekë

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Rritja 07/12
<b>Të ardhurat tat.</b>	264,288	276,352	295,982	328,729	315,397	325,306	23%
<b>Te ardhurat nga TP</b>	13,000	23,272	30,611	33,862	29,493	29,754	128%

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Rritja 13/19
<b>Të ardhurat tat.</b>	293,910	335,038	355,610	376,014	398,201	424,445	447,337	52%
<b>Të ardhurat nga TP</b>	28,412	28,503	31,803	32,073	36,200	37,300	41,900	47%

*Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë*

Gjatë taksës së sheshtë, nga viti 2007 deri në vitin 2012 mund të shohim që kemi një rritje të konsiderueshme të të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit nga 264.288 milionë lek në vitin 2007 në 325.306 milionë lek në vitin 2012 apo rreth 23%

Poashtu kemi një rritje të konsiderueshme të të ardhurave nga tatimi personal nga 13.000 në vitin 2007 në 29.754 milionë lekë në vitin 2012 apo rreth 128%.

Përsa i përket periudhës së taksës progresive , gjatë kësaj periudhe kemi poashtu një rritje të theksuar të të ardhurave tatimore nga 293.910 milionë lekë në 447.337 milionë lekë apo rreth 52%.

Kjo rritje kryesisht është mbështetur në rritjen e të ardhurave nga TVSH, ku si disa nga shkaqet e kësaj rritje janë edhe hapja e bizneseve të reja nga viti 2013-2019 ku kemi rreth 50.000 biznese të reja, poashtu kemi njëkohësisht rritje të konsumit meqenëse taksa



progresive tatimon më pak të varfërit dhe më shumë të pasurit , i bie që si pasojë e kësaj shtresa e lartë do të konsumonte përsëri njësoj, thjeshtë do të kursej më pak ndërsa shtresa e ulët presupozohet që të konsumoj më shumë për shumën e parave që u ngel në dispozicion.

Ndërsa tek të ardhurat nga tatimi personal, poashtu kemi një rritje të theksuar nga 28.412 milionë lek në vitin 2013 në 41.900 milionë lekë në vitin 2019 apo një rritje prej rreth 47%

Pra mund të kuptojmë që efekt më të madh pozitiv në të ardhurat tatimore ka pasur taksa progresive sepse mund të vërejmë një rritje më të theksuar si nga tatimi personal edhe nga të ardhurat totale tatimore.

#### IV.6.3 Krahasimi i investimeve të huaja në mes të periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Mesatarja
Investimet si % e PBB	6.1%	9.7%	11.2%	9.1%	8.1%	7.5%	8.61%
Investimet në million \$	647	881	950	1,043	846	834	866

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatarja
Investimet si % e PBB	9.8%	8.7%	8.7%	8.8%	7.9%	8%	7.9%	8.54%
Investimet në million \$	1,225	1,074	910	1,037	1,128	1,208	1,161	1,106

**Burimi: Banka Botërore**

Investimet gjatë periudhës së aplikimit të tatimit të sheshtë nga viti 2007 deri në vitin 2012 kanë pësuar rritje të konsiderueshme edhe atë nëse e shohim mesataren e investimeve gjatë kësaj periudhe, kemi një mesatare të investimeve të huaja prej 866 milionë dollarë në vit.

Gjithashtu gjatë zbatimit të tatimit progresiv gjatë periudhës 2013-2019, kemi një rritje mjaft të theksuar të investimeve të huaja edhe atë nëse përlllogarisim një mesatare gjatë 7 viteve , kemi një mesatare prej 1.106 milionë dollarë në vit.

Domethënë nëse krahasojmë periudhën e tatimit të sheshtë me periudhën e tatimit progresiv, do të shohim që jo vetëm që nuk kemi rënie të investimeve pavarësisht rritjes së barrës tatimore, por kemi rritje të investimeve të huaja me rreth 240 milionë dollarë krahasuar me mesataren e periudhës së tatimit të sheshtë apo një rritje prej rreth 27%.

IV.6.4. Krahasimi i borxhit publik në mes të periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012
<b>Borxhi Publik në mil. Lekë</b>	517,031	595,883	682,546	715,371	772,732	828,265
<b>Borxhi Publik si % e PBB</b>	53.48%	54.77%	59.68%	57.71%	59.40%	62.12%
<b>Rrit. e GDP/Rrit. e borxhit</b>	413%	140%	72%	291%	106%	57%

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Borxhi P. në milionë lekë</b>	885,083	977,957	1,043,212	1,066,500	1,087,342	1,106,285	1,112,626
<b>Borxhi P. si % e GDP</b>	65.56%	70.13%	72.66%	71.01%	70.09%	67.85%	65.84%
<b>Rrit. e GDP/Rrit. e borxhit</b>	183%	48.72%	59.76%	163.92%	375.04%	449.08%	673.65%

**Burimi: Ministria e Financave, Banka Botërore**

Përsa i përket borxhit publik në Shqipëri, mund të shohim që gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012, kemi një rritje të borxhit publik nga 517.031 milionë lekë në vitin 2007, në 828,265 milionë lekë në vitin 2012, dmth kemi një rritje prej 311.234 milionë lek për 6 vite që nëse e përkëthejmë në përqindje , një rritje prej rreth 60%.

Ndërsa gjatë periudhës së taksës progresive 2013-2019, kemi poashtu një rritje të theksuar të borxhit publik nga 885.083 milionë lekë në vitin 2013 në 1.112.626 milionë lekë në vitin 2019, një differencë prej 227.543 milionë lekë për 7 vite apo përkthyer në përqindje, një rritje prej rreth 25%.

Me këtë kuptojmë që borxhi publik është thelluar më tepër gjatë periudhës së taksës së sheshtë me një mesatare vjetore prej 51.872 milionë lekë në vit krahasuar me periudhën e taksës progresive me një mesatare vjetore prej rreth 32.506 milionë lekë dhe realisht kjo është e pritshme sepse efekti dhe qëllimi afatgjatë i taksës margjinale është stabilizimi e borxhit publik.

Poashtu nëse e analizojmë Produktivitetin Margjinal të Borxhit Publik gjatë dy periudhave, mund të vërejmë që gjatë periudhës së taksës progresive 2013-2019 kemi një produktivitet margjinal më të lartë të borxhit sidomos pas vitit 2016 deri në vitin 2019 ku borxhi i konvertuar në rritje ekonomike rezulton rreth 673%.

IV.6.5 Krahasimi i konsumit në mes të periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Mesatarja
Konsumi në milion \$	9,440	10,334	10,443	10,646	10,820	10,834	10.419
Konsumi si % e GDP	92.2%	93.5%	91.9%	89.3%	89.3%	88.8%	

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatarja
Konsumi në mil. \$	11,047	11,405	11,508	11,789	12,087	12,449	12,869	11.879
Konsumi si % e GDP	91.1%	92.2%	91.8%	92.2%	91.1%	90.2%	91.8%	

*Burimi: Banka botërore*

Konsumi gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012, ka pësuar rritje të vazhdueshme.

Duke e krahasuar me vitin e parë të aplikimit të taksës së sheshtë, vitin 2007 me vitin 2012, mund të shohim se kemi një rritje prej 1.394 milionë dollarë apo 14.7%.

Nëse e shohim periudhën e tatimit progresiv, mund të vërejmë që kemi poashtu një luhatje të konsumit gjatë 7 viteve të zbatimit por nëse krahasojmë vitin e parë të taksës progresive , vitin 2013 kur konsumi ka qenë 11.047 milionë dollarë me vitin 2019 kur konsumi është 12.869 milionë dollarë, mund të shohim që kemi një rritje prej 1,822 milionë dollarë për 7 vite, apo rreth 16.4%.

Si përfundim mund të shohim që gjatë periudhës së taksës progresive, konsumi ka pësuar një rritje më të madhe duke krahasuar edhe mesataren e konsumit të 6 viteve të taksës së sheshtë prej 10.419 milionë dollarë dhe mesatares së 7 viteve të taksës progresive prej 11.879 milionë dollarë apo një diferencë prej rreth 1.460 milionë dollarë , që është rreth 14% më e lartë.

Këtë diferencë të rritjes së konsumit e arsyeton filozofia e qeverisë majtiste e cila me politikën e sajë tatimore dhe rritjen e ndihmave për familjet në nevojë përmes asistencave sociale, subvencionim të një pjese të kostos së energjisë elektrike dhe ndihma të tjera të cilat bëjnë që ajo shtresë e popullatës të ketë më shumë para në dispozicion për të shpenzuar dhe kjo rezulton në rritjen e konsumit të përgjithshëm.

## KAPITULLI V: EFEKTET SOCIALE TË TATIMIT TË SHESHTË GJATË PERIUdhËS 2007 – 2012

*The longer our graduation lines are today, the shorter our unemployment lines will be tomorrow.*

**George H. W. Bush**

### V.1. Papunësia gjatë periudhës së tatimit të sheshtë


Papunësia është një ndër problemet themelore në vendet e Ballkanit dhe në Shqipëri poashtu , prandaj edhe njëri ndër objektivat dhe premtimet themelore të ç’do qeverie është ulja e normës së papunësisë.

Papunësia është një indikatorë social i cili është i ndikuar nga të gjithë instrumentat ekonomik duke filluar nga politika monetare ekspansive e cila tenton që përmes uljes së normës së interesit , të rrisë ofertën monetare në treg me qëllim të stimulimit të investimeve , stimulimin e prodhimit dhe uljen e normës së papunësisë. Nga ana tjetër edhe qeveria me një politikë fiskale ekspansive, duke rritur shpenzimet qeveritare dhe duke ulur taksat tenton të nxisë konsumin, kërkesën agregate dhe në këtë mënyrë tenton të ndikojë në uljen e normës së papunësisë.

Edhe pse duket e lehtë për tu menaxhuar, është një proces mjaft i kompleks sepse zbatimi i të dy politikave me qëllim të uljes së papunësisë shkaktojnë një ofertë të lartë moneare në treg e cila rezulton me inflacion të lartë dhe të pakontrolluar.

Poashtu edhe në Shqipëri gjatë reformave tatimore të bëra në vitin 2007 , me uljen e barrës tatimore si objektivi i qeverisë ishte edhe ulja e normës së papunësisë ku më poshtë kemi tabelën e cila përshkruan lëvizjen e normës së papunësisë gjatë viteve 2007-2012.

**Grafiku 12: Norma e papunësisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012**



**Burimi: Banka Botërore**

Në këtë tabelë mund të vërehet trendi i normës së papunësisë gjatë viteve kur aplikohet taksa e sheshtë dhe njëkohësisht Shqipëria gjatë këtyre viteve ka qenë një ndër vendet me barren më të ulët tatimore dhe kjo nuk ka dhënë rezultatet e pritura sepse mund të vërehet që gjatë vitit 2006 norma e papunësisë është rreth 13.8% , në vitin 2007 kemi një rritje të normës së papunësisë prej 16% , në vitin 2008 përsëri kemi një ulje deri në 13.01%, në vitin 2009 kemi rritje prej 0.6% të normës së papunësisë ku arrin në 13.07 dhe në vitin 2012 është viti i fundit që aplikohet kjo taksë arrin në 13.04%.

## V.2 Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës 2007-2012

Një tregues i rëndësishëm për efektivitetin e sistemit tatimorë është edhe numri i kompanive aktive në treg sepse sa më i madh ky numër, aq më shumë funksionon tregu i cili është rregullatori më i mirë i ekonomisë.

**Tabela 8: Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012**

Ndërmarrja/Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Mikro					96,429	94,025
E vogël					4,952	5,396
E mesme					4,164	3,898
E madhe					958	956
Totali	80,077	94,533	94,953	103,038	106,503	104,275

**Burimi: Instituti i statistikave- Instat**

Nëse analizojmë numrin e kompanive aktive gjatë periudhës 2007-2012, mund të vërehet që kemi një rritje të numrit të kompanive nga 80,077 ndërmarrje në vitin 2007 në 104,275 ndërmarrje në vitin 2012, një rritje prej 24.198 ndërmarrjesh për 6 vite apo rreth 30%. Nëse e analizojmë strukturën e ndërmarrjeve aktive, mund të vërehet që rreth 90% janë ndërmarrje mikro me 0 deri në 4 punëtorë, rreth 5% janë ndërmarrje të vogla prej 5 deri në 10 punëtorë, rreth 4% janë ndërmarrje të mesme nga 11 deri në 49 punëtorë dhe rreth 0.9% janë ndërmarrje të mëdha me mbi 50 punëtorë.



### V.3 Shpërndarja e të ardhurave në periudhën e tatimit të sheshtë

Sipas (Easterly, 2000) vendet që kanë shtresën e mesme më të shëndoshë apo vendet në të cilat shtresa e mesme është dominuese, prirjen që të kenë një rritje më të shpejtë ekonomike.

Shqipëria dhe vendet tjera të Ballkanit si vende në zhvillim kanë dallim të lartë ndërmjet shtresave dhe sidomos vitet e fundit ky dallim zmadhohet si rezultat i zvogimit të shtresës së mesme.

Gjatë periudhës së taksës së sheshtë nga viti 2007 deri në vitin 2012, për sa i përket shpërndarjes së të ardhurave mund të vërejmë që kemi një shpërndarje ku në vitin 2007 30.6% e të ardhurave totale shkojnë për 10% të popullsisë që llogaritet si shtresë e lartë, 48.6% e të ardhurave shkojnë për 40% të popullsisë që llogaritet si shtresë e mesme dhe rreth 20.7% e të ardhurave totale shpërndahen në shtresën e ulët të popullsisë që është rreth 50%.

**Tabela 9: Shpërndarja e të ardhurave nëpër shtresa në periudhën e tatimit të sheshtë 2007-2012**

Shtresa/Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Shtresa e lartë 10%	30.6%	31.8%	31.5%	31.1%	31.4%	31.6%
Shtresa e mesme 40%	48.6%	47.5%	47.6%	47.9%	47.7%	47.4%
Shtresa e ulët 50%	20.7%	20.7%	20.8%	21%	21%	21%

*Burimi: Baza e të dhënave të pabarazisë botërore*

Në vitin 2008 mund të vërejmë që kemi një rritje të shpërndarjes së të ardhurave tek shtresa e lartë deri në 31.8%, rënie të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e mesme deri në 47.5% dhe në shtresën e ulët vazhdon shpërndarja e të ardhurave me rreth 20.7%.

Në vitin 2009 mund të shohim që kemi rënie të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e lartë deri në 31.5%, kemi rritje të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e mesme deri në 47.6% dhe kemi rritje të shpërndarjes së të ardhurave tek shtresa e ulët deri në 20.8%.


Nëse e krahasojmë vitin e parë të aplikimit të taksës së sheshtë, vitin 2007 dhe vitin 2013, mund të vërejmë që kemi një rritje të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e lartë nga 30.6% në vitin 2007 në 31.6% në vitin 2012, një rritje prej 1.2%, në shtresën e mesme kemi një rënie të shpërndarjes së të ardhurave prej 48.6% në 47.4%, një rënie prej 1.2%, ndërsa në shtresën e ulët mund të vërejmë që kemi një rritje të shpërndarjes së të ardhurave prej 0.3%, nga 20.7% në 21%. Me këtë mund të kuptojmë që taksë e sheshtë ka pasur efekt pozitiv në shtresën e lartë dhe në shtresën e ulët ndërsa efekt negativ në shtresën e mesme për shkak se kemi rënie të shpërndarjes së të ardhurave në këtë shtresë.

#### V.4 Koeficienti Gini gjatë periudhës së tatimit të sheshtë

Koeficienti Gini është një parametër statistikore që mat pabarazinë në një vend përmes shpërndarjes së të ardhurave apo të pasurisë dhe si i tillë përdoret nga pothuajse të gjithë ekonomistët dhe organizatat ndërkombëtare për të bërë një analizë ekonomike dhe sociale të aspektit të lartëpërmendur.

Nëse e analizojmë rastin e Shqipërisë, mund të shohim që gjatë nga viteve 2005-2012 kemi një rënie të koeficientit Gini nga 30.6 vitin 2005 në 30 vitin 2008 dhe në 29 në vitin 2012.

**Grafiku 13: Koeficienti Gini gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012**



**Burimi: Banka Botërore**


Domethënë duke u bazuar në statistikat e mësipërme mund të vërehet që gjatë periudhës 2005 - 2012 kemi një rënie të pabarazisë sociale për rreth 1.6% nga viti 2005 dhe për rreth 1% nga viti 2008 dhe nga ky këndvështrim mund të kuptojmë që taksa e sheshtë ka pasur një efekt pozitiv në zvoglimin e pabarazisë.

#### V.5 Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë

Shkalla e varfërisë është poashtu një parametër i rëndësishëm statistikorë që na ndihmon të kemi një pasqyrë të qartë mbi mirëqenien sociale dhe ekonomike të popullsisë në një vend.

Shqipëria poashtu si vendet tjera të Ballkanit dhe si vend në zhvillim ka një shkallë të lartë të varfërisë siç mund ta shohim edhe më poshtë.

**Grafiku 14 Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit të sheshtë 2007-2012**



**Burimi: Banka Botërore**

Në vitin 2005 rreth 38.5% e popullatës jetojnë me më pak se 5.5\$ për kokë banori, në vitin 2008 kemi një rënie të kësaj norme për rreth 7.4% deri në 31.1% dhe në vitin 2012 kemi përsëri rritje të shkallës së varfërisë për 4.4% ku arrin deri në 34.5% shkak i të cilës mund të jetë edhe kriza globale efektet e së cilës ishin disavjeçare.



## KAPITULLI VI: EFEKTET SOCIALE TË GJATË PERIUdhËS SË TATIMIT PROGRESIV 2013-2019


*We must work together to ensure the equitable distribution of wealth, opportunity and power in our society.*

**Nelson Mandela**

### VI.1 Papunësia gjatë periudhës së tatimit progresiv

Pas ndryshimit të qeverisë në R. Shqipërisë në vitin 2013 filloi aplikimi i tatimit progresiv në të ardhura personale i cili vazhdon të aplikohet edhe sot. Gjatë kësaj periudhe nga viti 2013 deri në vitin 2019 norma e papunësisë ka pësuar luhatje të mëdha gjë të cilën mund ta shohim në tabelën e mëposhtme:

**Grafiku 15: Norma e papunësisë gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**



**Burimi: Banka Botërore**

Gjatë dy viteve të para të zbatimit të tatimit progresiv, kemi një rritje të papunësisë deri në 18.1% në vitin 2014, normë e cila mund të konsiderohet si normë më e lartë e papunësisë gjatë dy dekadave të fundit dhe është si rezultat i ngadalsimit të ekonomisë rritjes ekonomike të ulët dhe poashtu sipas (Instat, 2014) një shkak tjetër është sepse kemi rritje të numrit të personave që kërkojnë punë dhe zvoglim të numrit të personave që nuk janë të gatshëm për të punuar me rreth 3.5%.

Më pas nga viti 2015 deri në vitin 2019 si pasojë e rritjes ekonomike dhe rritjes së investimeve kemi një rënie të konsiderueshme të normës së papunësisë deri në 11.5% në vitin 2019 që gjithashtu është norma më e ulët e papunësisë gjatë dy dekadave të fundit.

## VI.2 Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës së tatimit progresiv

Nëse e analizojmë periudhën 2013-2019, do të shohim një rritje të theksuar të ndërmarrjeve aktive totale edhe atë nga viti 2013 që ka pasur 111.083 ndërmarrje , ka arritur në 162.342 ndërmarrje aktive në vitin 2019, një rritje prej 51.259 ndërmarrjesh apo rreth 46% më shumë.

**Tabela 10: Numri i ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**

Ndërmarrja/Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Mikro</b>	99,782	101.025	136,470	145,456	146,304	145,549	144,857
<b>E vogël</b>	5,235	5387	8172	7631	8,023	8,518	8,569
<b>E mesme</b>	4,660	4,647	5994	5902	6297	6,801	6,932
<b>E madhe</b>	1,406	1478	1652	1690	1828	1,967	1,984
<b>Totali</b>	111.083	112.537	152.288	160.679	162.452	162.835	162.342

**Burimi: Instituti i statistikave**

Me këtë mund të vërejmë që pas reformave tatimore të vitit 2013, kur disa taksa për biznesin e vogël u zeruan dhe nga ana tjetër taksa progresive, kanë dhënë një efekt mjaft pozitiv në hapjen e kompanive të reja dhe zgjerimin e tregu.



Edhe atë nëse analizojmë biznesin mikro , mund të shohim që kemi një rritje të konsiderueshme ku në vitin 2013 kanë qenë 99.782 ndërmarrje aktive ndërsa në vitin 2019 kemi rreth 144.857 ndërmarrje aktive, domethënë kemi rreth 45.075 ndërmarrje të reja gjatë 7 viteve apo një rritje prej 45,27%.

Nëse analizojmë biznesin e vogël, në vitin 2013 kemi rreth 5.235 ndërmarrje të vogla aktive ndërsa në vitin 2019 kemi 8.569 ndërmarrje të vogla aktive, domethënë kemi një rritje prej 3.334 ndërmarrjesh apo rreth 63% më shumë.

Numri i ndërmarrjeve të mesme aktive poashtu është rritur, nga viti 2013 që kanë qenë 4.660 ndërmarrje aktive në 6.932 ndërmarrje aktive në vitin 2019. Domethënë kemi një rritje prej 2.272 ndërmarrjesh apo rreth 48% më shumë.

Përsa i përket ndërmarrjeve të mëdha, poashtu mund të vërehet që kemi rritje krahasuar me vitin 2013 kur numri i ndërmarrjeve aktive ka qenë 1.406 ndërsa në vitin 2019 ka arritur në 1.984 ndërmarrje aktive. Kemi një rritje prej 578 ndërmarrjesh apo rreth 41% më shumë.

### VI.3. Shpërndarja e të ardhurave në periudhën e tatimit progresiv

Gjatë periudhës së taksës progresive nga viti 2013 deri në vitin 2019 mund të shohim që në vitin e parë të aplikimit të kësaj takse, viti 2013 , kemi një shpërndarje të të ardhurave prej 33.1% tek 10% e popullësisë e cila llogaritet si shtresë e lartë, 47 % e të ardhurave tek shtresa e mesme e cila llogaritet rreth 40% e popullësisë dhe 19.9% e të ardhurave tek shtresa e ulët e cila llogaritet rreth 50% e popullësisë.

**Tabela 11: Shpërndarja e të ardhurave gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**

Shtresa/Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Shtresa e lartë 10%	33.1%	33.8%	33.8%	33.7%	33.9%	33.9%	34%
Shtresa e mesme 40%	47%	47.1%	46.8%	47%	46.8%	46.8%	46.7%
Shtresa e ulët 50%	19.9%	19.1%	19.5%	19.3%	19.3%	19.3%	19.3%

**Burimi: Baza e të dhënave të pabarazisë botërore**

Sipas (STIGLITZ, 2014) një ndër arsytet përse pabarazia e lartë e të ardhurave ka efekt negativ në performancën e ekonomisë është sepse pabarazia e lartë ndikon në uljen e kërkesës agregate. Kjo arsyetohet sepse shtresa e ulët shpenzon një pjesë të madhe të të ardhurave sepse e kanë të nevojshme ndërsa shtresa e lartë shpenzon një pjesë shumë më të vogël krahasuar me të ardhurat.

Nëse i analizojmë vitet në vazhdim, mund të vërejmë se në vitin 2014 kemi një rritje të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e lartë deri në 33.8%, rritje poashtu në shtresën e mesme prej 47% ndërsa në shtresën e ulët kemi rënie të shpërndarjes së të ardhurave prej 19.3%.

Nëse e krahasojmë vitin e parë të aplikimit të taksës progresive, vitin 2013 me vitin 2019, mund të vërejmë që kemi një rritje të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e lartë rreth 0.9% nga 33.1% në 34%, kemi një rënie të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e mesme nga 47% në 46.7% apo rreth 0.3% më pak dhe kemi poashtu rënie në shtresën e ulët nga 19.9% në 19.3% apo rreth 0.6% më pak.

Me këtë mund të arrijmë në përfundim që taksa progresive ka pasur ndikim pozitiv për shtresën e lartë ndërsa ndikim negativ në shtresën e mesme dhe shtresën e ulët.

Shkaku për këtë ndikim negativ është sepse pragjet e tatimit nuk janë të vendosura mirë dhe e afektojnë më shumë shtresën e mesme si shtresë më e shëndoshë.


Në Shqipëri taksa progresive do të kishte efekt më të madh në rishpërndarjen e të ardhurave nëse do të rritej ndihma ekonomike. Pra nëse vendos një tatim progresiv, teorikisht do marrësh më shumë para nga të pasurit dhe do i shpërndash në forma të ndryshme tek shtresat e ulëta ndërsa praktikisht kjo ka ndodhur por efektet e duhura nuk janë arritur pasi u bënë reforma në klasifikimin e përfituesve të ndihmave ekonomike sepse shumë familje nuk i përkisnin kësaj kategorie ndërsa ishin pjesë e përfituesve të kësaj ndihme.

#### VI.4. Koeficienti Gini gjatë periudhës së tatimit progresiv

Një ndër objektivat bazë të taksës progresive të vendosur në Shqipëri nga viti 2013 është ulja e pabarazisë sociale në të ardhura dhe zvogëlimi i dallimit në mes të shtresave.

Nëse analizojmë këtë periudhë nga viti 2014 e deri në vitin 2017 mund të vërejmë që kemi një luhatje të pabarazisë apo të shpërndarjes së të ardhurave siç mund ta shohim në tabelën e mëposhtme.

**Grafiku 16: Koeficienti Gini gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**



**Burimi: Banka Botërore**

Në vitin 2014 koeficienti Gini është rreth 34.6%, më pas në vitin 2015 kemi një rënie prej 1.7% ku arrin deri në 32.9%. Më pas në vitin 2016 kemi përsëri rritje të koeficientit Gini për rreth 0.8% dhe në vitin 2017 kemi rënie për rreth 0.5% që arrin deri në 33.2%.


Nëse e marrim vitin 2014 dhe e krahasojmë me vitin 2017, mund të vërejmë që kemi një rënie prej 1.4% të pabarazisë sociale apo të shpërndarjes së të ardhurave bazuar në koeficientin Gini ku nga 34.6% në vitin 2014 bie në 33.2% në vitin 2017.

#### VI.5. Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit progresiv

Një ndër mënyrat e funksionimit të taksës progresive është taksimi më i lartë i personave me të ardhura të larta dhe taksimi më i ulët i personave me të ardhura të ulta gjë që është e lidhur me objektivin e uljes shkallës së varfërisë në mënyrë direkte duke ju lënë më shumë para në dispozicion shtresës së ulët.

Në rastin e Shqipërisë mund të vërehet që gjatë viteve 2014-2017 kemi një rënie të shkallës së varfërisë si më poshtë.

**Grafiku 17: Shkalla e varfërisë gjatë periudhës së tatimit progresiv 2013-2019**



**Burimi: Banka Botërore**

Shkalla e varfërisë apo më sakt pjesa e popullatës që në vitin 2014 ka jetuar me më pak se 5.5\$ në ditë ka qenë rreth 37%e popullsisë.

Në vitin 2015 kemi rënie të kësaj norme me rreth 2.8% që është rreth 34.2%, normë e cila vazhdon të jetë edhe në vitin 2016. Në vitin 2017 kemi përsëri rënie të shkallës së varfërisë me rreth 0.4% ku kjo normë këtë vit arrin deri në 33.8%.

Domethënë gjatë taksës progresive nga viti 2014 deri në vitin 2017 kemi një rënie të shkallës së varfërisë me rreth 3.2% por edhe kjo nuk është e mjaftueshme për shkak të pragjeve jo mirë të vendosura.

## VI.6 KRAHASIMI NË MES TË DY PERIUDHAVE NGA ASPEKTI SOCIAL

### VI.6.1 Krahasimi i Normës së Papunësisë gjatë periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Mesatarja
Norma e papunësisë	16%	13.01%	13.07%	14.01%	13.5%	13.4%	13.83%

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatarja
<b>Norma e papunësisë</b>	15.9%	18.1%	17.2%	15.4%	13.6%	12.3%	11.5%	14.85%

**Burimi: Banka Botërore**

Nëse e krahasojmë vijueshmërinë e normës së papunësisë gjatë periudhës 2007-2012 dhe 2013-2019 mund të vërejmë që gjatë periudhës së aplikimit të tatimit të sheshtë, kemi një lëkundje të normës së papunësisë ku në vitin e parë të zbatimit të kësaj takse, kemi një rritje të normës së papunësisë nga 13.8% në 16% ndërsa në vitet në vazhdim kemi një rënie deri në 13.4% në vitin 2012 që është edhe viti i fundit i aplikimit të kësaj takse.

Gjatë kësaj periudhe norma mesatare e papunësisë është 13.83% gjatë 6 viteve të zbatimit ndërsa nga viti i parë der i në vitin e fundit të aplikimit të kësaj takse, kemi një rënie të normës së papunësisë rreth 2.6 pikë përqindje.

Nga ana tjetër, gjatë periudhës së tatimit progresiv nga viti 2013, mund të vërejmë që kemi poashtu një luhatje të normës së papunësisë ku në dy vitet e para të aplikimit të kësaj takse kemi një rritje të papunësisë deri në 18.1% në vitin 2014 ndërsa në vitet në vazhdim kemi një rënie të vazhdueshme të normës së papunësisë deri në 11.5% në vitin 2019.

Gjatë kësaj periudhe, norma mesatare e papunësisë krahasuar me periudhën e taksës së sheshtë është më e lartë, edhe atë 14.85% gjatë 7 viteve, por nga ana tjetër nga viti i dytë i zbatimit të kësaj takse, viti 2014 kur norma e papunësisë ishte rreth 18.1%, kemi një rënie prej 6.6 pikë përqindje.

Dhe nga kjo mund të konkludojmë që efekt më të madh pozitiv në normën e papunësisë ka taksa progresive gjatë kohës së cilës kemi një rënie të konsiderueshme të papunësisë krahasuar me periudhën e aplikimit të taksës së sheshtë por duhet të kemi parasysh se taksa progresive apo e sheshtë nuk është i vetmi faktorë që ka ndikuar në zvoglimin e papunësisë.

#### VI.6.2 Krahasimi i numrit të ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Nëse e krahasojmë numrin e ndërmarrjeve aktive gjatë periudhës e taksës së sheshtë dhe gjatë periudhës së taksës progresive, mund të vërejmë që kemi një rritje më të theksuar të numrit të ndërmarrjeve gjatë periudhës së taksës progresive, duke filluar nga biznesi mikro e deri tek biznesi i madh.

Ndërmarrja/Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012
<b>Mikro</b>					96,429	94,025
<b>E vogël</b>					4,952	5,396
<b>E mesme</b>					4,164	3,898

<b>E madhe</b>					958	956
<b>Totali</b>	80,077	94,533	94,953	103,038	106,503	104,275

<b>Ndërmarrja/Viti</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
<b>Mikro</b>	99,782	101.025	136,470	145,456	146,304	145,549	144,857
<b>E vogël</b>	5,235	5387	8172	7631	8,023	8,518	8,569
<b>E mesme</b>	4,660	4,647	5994	5902	6297	6,801	6,932
<b>E madhe</b>	1,406	1478	1652	1690	1828	1,967	1,984
<b>Totali</b>	111.083	112.537	152.288	160.679	162.452	162.835	162.342

**Burimi: Instat**

Këtë mund ta vërejmë duke u bazuar në atë se nëse e krahasojmë numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive në periudhën e taksës progresive me periudhën e taksës së sheshtë, mund të shohim që gjatë periudhës së taksës së sheshtë kemi një rritje vjetore mesatare të numrit të ndërmarrjeve prej 4033 ndërmarrjesh të reja në vit ndërsa gjatë periudhës së taksës progresive kemi një rritje mesatare vjetore prej 7.322 ndërmarrjesh të reja apo më sakt, rreth 3.289 apo rreth 44% më shumë ndërmarrje aktive.

### VI.6.3. Krahasimi i shpërndarjes së të ardhurave gjatë periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

<b>Shtresa/Viti</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>
<b>Shtresa e lartë 10%</b>	30.6%	31.8%	31.5%	31.1%	31.4%	31.6%
<b>Shtresa e mesme 40%</b>	48.5%	47.5%	47.6%	47.9%	47.7%	47.4%
<b>Shtresa e ulët 50%</b>	20.7%	20.7%	20.8%	21%	21%	21%

<b>Shtresa/Viti</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
<b>Shtresa e lartë 10%</b>	33.1%	33.8%	33.8%	33.7%	33.9%	33.9%	34%
<b>Shtresa e mesme 40%</b>	47%	47.1%	46.8%	47%	46.8%	46.8%	46.7%
<b>Shtresa e ulët 50%</b>	19.9%	19.1%	19.5%	19.3%	19.3%	19.3%	19.3%

Burimi: Baza e të dhënave të pabarazisë botërore

Nëse e krahasojmë periudhën e taksës së sheshtë me periudhën e taksës progresive në aspektin e shpërndarjes së të ardhurave, mund të vërejmë që:



- gjatë taksës së sheshtë kemi rritje të shpërndarjes së të ardhurave në shtresën e lartë për rreth 1% për 6 vite apo mesatarisht 0.17% në vit ndërsa gjatë taksës progresive kemi një rritje prej 0.9% për 7 vite apo mesatarisht 0.12% në vit
- në shtresën e mesme gjatë taksës së sheshtë kemi rënie të shpërndarjes së të ardhurave për rreth 1.2% në 6 vite apo mesatarisht 0.2% në vit ndërsa gjatë periudhës së taksës progresive kemi një rënie të shpërndarjes së të ardhurave prej 0.3% në 7 vite apo mesatarisht 0.04% në vit.
- Në shtresën e ulët gjatë taksës së sheshtë kemi një rritje të shpërndarjes së të ardhurave prej 0.3% për 6 vite apo rreth 0.05% në vit ndërsa gjatë taksës progresive kemi një rënie të shpërndarjes së të ardhurave rreth 0.6% në 7 vite apo mesatarisht 0.08% në vit.

Me këtë mund të arrijmë në konkluzionin se taksa progresive ka pasur efekt më të ulët në orientimin e të ardhurave në shtresën e lartë gjë që konsiderohet si përparësi, poashtu ka pasur efekt më të ngadalshëm në zvoglimin e të ardhurave në shtresën e mesme që poashtu është një përparësi ndërsa tek shtresa e ulët taksa e sheshtë ka dhënë efekt më pozitiv sepse gjatë kësaj takse kemi riorientim të të ardhurave tek kjo shtresë.

#### VI.6.4. Krahasimi i pabarazisë sociale -Koeficienti Gini gjatë periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Viti	2005	2008	2012
<b>Koeficienti Gini në %</b>	30.6%	30%	29%

Viti	2014	2015	2016	2017
<b>Koeficienti Gini në %</b>	34.6%	32.9%	33.7%	33.2%

**Burimi: Banka Botërore**

Nëse e bëjmë krahasimin në mes të periudhës së taksës së sheshtë nga viti 2007 deri në vitin 2012 dhe periudhës së taksës progresive nga viti 2013 deri në 2019 në aspektin e pabarazisë sociale në të ardhura, mund të shohim se gjatë periudhës së taksës së sheshtë kemi një rënie të Gini koeficientit apo të pabarazisë nga 30% në 29% për 4 vite apo rreth 0.25% në

vit, ndërsa tek periudha e taksës progresive kemi poashtu një rënie të Gini Koeficientit nga 34.6% në vitin 2014 në 33.2% në vitin 2017, që i bie një rënie prej rreth 0.35% në vit.

Me këtë mund të kuptojmë që taksa progresive ka pasur një efekt pozitiv më të lartë se taksa e sheshtë në uljen e pabarazisë sociale dhe ekonomike në të ardhura por përsëri pabarazia më e lartë ka qenë gjatë periudhës së taksës progresive.

#### VI.6.5 Krahasimi i shkallës së varfërisë gjatë periudhës 2007-2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013-2019 (tatimi progresiv)

Viti	2005	2008	2012
Shkalla e varfërisë në %	38.5%	31.1%	34.5%

Viti	2014	2015	2016	2017
Shkalla e varfërisë në %	37%	34.2%	34.2%	33.8%

*Burimi: Banka Botërore*

Nëse e krahasojmë periudhën e taksës së sheshtë nga viti 2007 deri në 2012 me periudhën e taksës progresive nga viti 2013 deri në vitin 2019 nga aspekti i shkallës së varfërisë, mund të vërejmë që gjatë periudhës së taksës së sheshtë nga viti 2008 deri në vitin 2012 kemi një rritje të shkallës së varfërisë nga 31.1% në 34.5%, një rritje prej 4.4% apo rreth 1.1% në vit. Ndërsa nga ana tjetër në periudhën e taksës progresive kemi një rënie të varfërisë nga 37% në vitin 2014 deri në 33.8% në vitin 2017, një rënie prej 3.2% apo rreth 0.8% në 4 vite.

Me këtë mund të vërejmë që gjatë periudhës së taksës progresive kemi një ulje të varfërisë krahasuar me periudhën e taksës së sheshtë.

## KAPITULLI VII: ANALIZA EMPIRIKE

### VII.1. Qëllimi i analizës empirike dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variables së varur

Ndërtimi i një modeli ekonometrik është një çështje mjaft e rëndësishme e cila ka për qëllim të mbrojë dhe arsyetojë argumentin përfundimtarë të një studimi sepse përmes kësaj analize mund të përcaktohet saktësia e indikatorëve të zgjedhur dhe rëndësia e tyre në variablën e varur.

Në këtë model, si variabël të varur kemi marrë PBB - prodhimi i brendshëm bruto sepse është një tregues ekonomik i vlerës së përgjithshme të produkteve dhe shërbimeve të bazuara në çmimet e tregut të cilat janë prodhuar brenda një vendi në një periudhë të caktuar që zakonisht është një vit. Poashtu është një ndër indikatorët me anë të të cilit përcaktohet rritja dhe zhvillimi ekonomik i një vendi dhe është i lidhur dhe i ndikuar nga shumë indikatorë tjerë.

Janë përdorur 13 observime, apo më saktë është analizuar periudha nga viti 2007 deri në vitin 2019 për variablat e lartëpërmendur. Të dhënat janë vjetore dhe si burim kanë kryesisht Ministrinë e financave të R. Shqipërisë dhe Bankën Botërore.

## VII.2 Përcaktimi i modelit dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variablave të pavarura (shpjeguese)

Si variabla të pavarur në këtë studim kemi të ardhurat buxhetore, investimet, deficitin buxhetorë dhe konsumin. Këto variabla nuk janë përzgjedhur rastësisht por sepse janë disa nga variablat ekonomik që kanë ndikim më të madh në PBB.

Të ardhurat buxhetore janë mjete financiare të cilat i grumbullon shteti nga tatimet me anë të të cilave financon shpenzimet e ndryshme qeveritare. Ky tregues është i rëndësishëm në modelin tonë për të parë se çfarë ndikimi kanë pasur të ardhurat tatimore në PBB.

Investimet janë poashtu një tregues dhe një variabël i rëndësishëm ekonomik në këtë studim sepse mund të shohim se çfarë ndikimi kanë ato në PBB dhe a ka pasur ndikim në investime efekti i kalimit nga tatimi i sheshtë në tatimin progresiv.

Deficiti buxhetorë është poashtu një tregues ekonomik mjaft i rëndësishëm i këtij modeli sepse me këtë model mund të shohim se çfarë ndikimi ka pasur ky tregues në PBB dhe si ka vijuar ecuria e këtij indikator pas ndryshimit të politikave në vitin 2013.

Konsumi është variabla e fundit por jo më pak e rëndësishme e përdorur në këtë model dhe është e zgjedhur si indikatorë për analizë sepse rreth 90% e PBB-së është mvarur nga konsumi.

Hipotezat mbi të cilat ndërtohet modeli ekonometrik janë:

- Të ardhurat buxhetore kanë ndikim pozitiv në PBB
- Investimet kanë ndikim pozitiv në PBB
- Deficiti buxhetorë ka efekt negativ në PBB

- Konsumi poashtu ka efekt pozitiv në PBB

### VII.3 Rezultatet nga analiza empirike

Nga regresioni i mëposhtëm mund të kuptojmë që indikatorët apo variablat e përzgjedhur për tu analizuar janë të rëndësishëm statistikisht dhe të vlefshëm në analizën krahasuese të këtij studimi në mes të dy periudhave të përzgjedhura, asaj të tatimit të sheshtë 2007-2013 dhe periudhës së tatimit progresiv 2013-2019.

VARIABLAT	KOEFICIENTI I NDIKIMIT	GABIMI STANDARD ST. ERROR	T-TEST	P-VALUE
TË ARDHURAT BUXHETORE	0.9972644	0.2266892	4.40	0.002
INVESTIMET	1.333991	0.5184903	2.57	0.033
DEF. BUXHETOR	0.0910384	0.041881	2.17	0.061
KONSUMI	0.3907917	0.195827	2.00	0.081
CONSTANT	2860.378	1168.3	2.45	0.040
R-squared	0.9975			
Adj. R-squared	0.9965			
F-statistics	848.95			
Prob > F	0.0000			

$$\text{GDP} = 2860 + 0.99 \text{ Rev.} + 1.33 \text{ Inv.} + 0.091 \text{ Def.B} + 0.39 \text{ Cons.}$$

Më sipër kemi të paraqitur regresionin me anë të të cilit mund të testojmë ndikimin dhe rëndësinë statistikore të çdonjërës nga variablat.

Nëse analizojmë rëndësinë e faktorëve apo variablave të zgjedhur, do të shohim që të gjithë variablat janë të rëndësishëm në model sepse P-vlera është më e ulët se 0.1 ndërsa T-testi është më i lartë se 1.8.

Nga ana tjetër gabimi standard është i lartë për shkak se numri i observimeve është i vogël dhe vlerat numerike të variablave kanë lëkundje të mëdha siç janë investimet.

Sipas metodës së katërorëve të vegjël mund të shohim ndikimin e variablave në ndryshimin e GDP-së përmes koeficientëve përkatës edhe atë:

R-squared na tregon se sa afër janë observimet me vijën e regresionit edhe atë në modelin e mësipërm kemi R-squared = 0.9975 apo rreth 99.75%.

Adj R-squared shpjegon që modeli i vlerësuar shpjegon rreth 99.65 % të variancës së PBB-së.

F-statistics tregon rëndësinë statistikore të të gjithë variablave bashkarisht ku në regresionin e mësipërm  $F\text{-statistics} = 848.95$

Prob  $F\text{-statistics} = 0.0000$  dmth është një tregues sinjifikant i cili na tregon që variablat e pavarura së bashku në mënyrë sinjifikante e sqarojnë variablën e varur.

Të ardhurat buxhetore si variabël e rëndësishme në model kanë një ndikim të lartë pozitiv në rritjen e GDP-së sepse me rritjen e të ardhurave buxhetore me 1 milionë dollarë, do të kemi rritje të PBB-së me 0.99 milionë dollarë.

Investimet kanë poashtu një ndikim të madh në PBB ku me rritjen e investimeve për 1 milionë dollarë, kemi rritjen e PBB-së për 1.33 milionë dollarë

Deficiti buxhetorë ka pasur një ndikim më të ulët në PBB por me ndikim pozitiv ku me rritjen e deficitit buxhetorë për 1 milionë dollarë, kemi rritje të PBB-së për 0.091 milionë dollarë.

Konsumi poashtu sipas modelit ekonometrik ka pasur ndikim pozitiv në PBB sepse me rritjen e konsumit për 1 milionë dollarë, kemi rritjen e PBB-së me 0.390 milionë dollarë.

#### VII.4 Testimi i hipotezave

Testimi i hipotezave të studimit	Pranojmë ose hedhim poshtë (për testimin e hipotezave të ngritura në fillim të studimit shërbehemi me rezultatet nga ekzaminimi i indikatorëve makroekonomik përgjatë periudhave 2007 - 2012 (tatimi i sheshtë) dhe 2013 - 2019 (tatimi progresiv)
<i>H1: Një tatim progresiv mbi të ardhura në rastin e Shqipërisë përcillet me një rritje ekonomike të ngadalësuar.</i>	Gjatë ekzaminimit të rritjes ekonomike gjatë periudhës së tatimit progresiv, mund të konstatojmë se: <b><i>një tatim progresiv mbi të ardhura në rastin e Shqipërisë përcillet me një rritje ekonomike të ngadalësuar sidomos vitet e para ku sillet rreth 1% ndërsa në vazhdim rritja ekonomike rimëkëmbet deri në rreth 4% në vitin 2018 dhe ka trend rritës, e rrjedhimisht hipoteza e parë është pjesërisht e pranueshme.</i></b>
<i>H2: Tatimi progresiv ndikon pozitivisht në uljen e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave.</i>	Gjatë ekzaminimit të pabarazisë gjatë periudhës së tatimit progresiv, mund të konstatojmë se: <b><i>Hipoteza e dytë qëndron poashtu pasi nëse analizojmë Gini</i></b>

	<i>Koeficientin mund të vërejmë që gjatë periudhës së tatimit progresiv kemi një rënie të pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave rreth 1.6% për 4 vite ndërsa krahasuar me tatimin e sheshtë gjatë të cilit kemi rënie prej 1% në 5 vite.</i>
<i>H3: Një sistem tatimorë progresiv ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave tatimore.</i>	Gjatë ekzaminimit të të ardhurave tatimore gjatë periudhës së tatimit progresiv mbi të ardhurat, konstatojmë se: <b>Gjatë periudhës së tatimit progresiv mund të vërejmë që kemi rritje të të ardhurave tatimore si në aspektin total si të ardhura të përgjithshme tatimore rreth 53% për 7 vite, ashtu edhe në veçanti kemi rritje të të ardhurave nga tatimi personal rreth 47% dhe me këtë kuptojmë që edhe kjo hipotezë qëndron.</b>
<i>H4: Sistemi tatimorë progresiv ka impakt pozitiv në investimet e huaja.</i>	Gjatë ekzaminimit të investimeve të huaja gjatë periudhës së tatimit progresiv mbi të ardhurat, konstatojmë se: <b>Taksa e lartë marginale ka pasur një efekt pozitiv në shumë aspekte si ekonomike ashtu edhe sociale. Dhe një ndër indikatorët që ka pasur trend pozitiv gjatë periudhës së tatimit progresiv janë edhe investimet e huaja sepse investimet mesatare vjetore gjatë periudhës së taksës së progresive kanë arritur në rreth 1.1 miliard dollarë. Domethënë hipoteza qëndron.</b>
<i>H5: Tatimi progresiv ndikon në uljen e varfërisë.</i>	Gjatë ekzaminimit të varfërisë gjatë periudhës së tatimit progresiv mbi të ardhurat, konstatojmë se: <b>Kjo hipotezë poashtu qëndron sepse gjatë periudhës së tatimit progresiv kemi një ulje të shkallës së varfërisë me rreth 0.8% në vit.</b>
<i>H6: Sistemi tatimorë progresiv ndikon pozitivisht në stabilizimin dhe uljen e borxhit publik</i>	Gjatë ekzaminimit të borxhit publik gjatë periudhës së tatimit progresiv mbi të ardhurat, konstatojmë se: <b>Gjatë periudhës së tatimit progresiv mund të vërejmë që kemi një stabilizim të borxhit publik krahasuar me periudhën e tatimit të sheshtë sepse si raport i borxhit publik me PBB-në kemi një rritje prej 0.28% për 7 vite dhe mund të themi që njëri ndër objektivat afatgjate të këtij lloj tatimimi është realizuar.</b>

VII.5. Rezultatet nga aplikimi i tatimit të sheshtë gjatë periudhës 2007 - 2012, dhe tatimit progresiv 2013 - 2019, krahasimi dhe ndikimi i tyre në kontekst ekonomik dhe social në Republikën e Shqipërisë.

Pas një analize të thellë të periudhës 2007-2012, kur tatimi i sheshtë ishte në zbatim dhe periudhës 2013-2019 kur tatimi progresiv vazhdon të jetë në zbatim dhe pas krahasimeve të efekteve dhe rezultateve të tyre, mund të arrijmë në përfundimin se taksa progresive ka dhënë efekte më të mira në aspektin e përgjithshëm ekonomik dhe social edhe atë sikurse në tabelën vijuese:

Nr	Aspekti Ekonomik	Tatimi i sheshtë	Tatimi progresiv	Shpjegim
1.	Rritja ekonomike	Avantazh		Rritja ekonomike mesatare në periudhën e taksës së sheshtë është më e lartë por ka tendencë rënëse deri në nivelet më të ulta në vitet e fundit të zbatimit të sajë.
2.	Të ardhurat e përgjithshme tatimore		Avantazh	Të ardhurat e përgjithshme tatimore gjatë periudhës së tatimit progresiv kanë pësuar rritje të mëdha.
2A	Të ardhurat nga TP		Avantazh	Të ardhurat nga TP janë rritur dukshëm gjatë periudhës së tatimit progresiv dhe efekti më pozitiv i kësaj është se është tatimuar shtresa e lartë
3.	Investimet e huaja		Avantazh	Edhe pse investimet e huaja në raport me PBB-në periudhën e tatimit progresiv janë pak më të ulta përshkak se kemi rritje të PBB-së por në vlerë monetare dhe sasiore janë më të larta.
4.	Konsumi		Avantazh	Konsumi gjatë kohës së tatimit progresiv është në nivele më të larta veçanërisht në vitet e fundit të zbatimit të saj
5.	Borxhi Publik		Avantazh	Borxhi Publik pëson rritje vjetore më të ulët gjatë periudhës së tatimit progresiv dhe shkon drejt stabilizimit
	<b>Aspekti Social</b>			
6.	Papunësia		Avantazh	Papunësia gjatë periudhës së tatimit progresiv bie në nivelet më të ulta të sajë.
7.	Numri i ndërmarrjeve		Avantazh	Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve ka pësuar rritje të konsiderueshme gjatë periudhës së tatimit progresiv veçanërisht

				ndërmarrjet mikro.
8.	Shpërndarja e të ardhurave			
8A	Shtresa e lartë		Avantazh	Shpërndarja e të ardhurave në shtresën e lartë ka një rritje më të vogël gjatë periudhës së tatimit progresiv.
8B	Shtresa e mesme		Avantazh	Shpërndarja e të ardhurave tek shtresa e mesme ka një rënie më të vogël në periudhën e tatimit progresiv krahasuar me periudhën e tatimit të sheshtë.
8C	Shtresa e ulët	Avantazh		Shpërndarja e të ardhurave në shtresën e ulët është rritur gjatë periudhës së tatimit të sheshtë.
9.	Koeficienti Gini		Avantazh	Gjatë periudhës së tatimit progresiv kemi një rënie më të lartë të pabarazisë sociale në aspektin e të ardhurave krahasuar me periudhën e tatimit sheshtë.
10.	Shkalla e varfërisë		Avantazh	Shkalla e varfërisë ka pësuar rënie në periudhën e tatimit progresiv me rreth 0.8% në vit ndryshe nga periudha e tatimit të sheshtë gjatë të cilës kemi rritje rreth 1.1% në vit.

## KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Kokluzionet që dalin nga ky studim janë:

- Tatimi i sheshtë jo ç'doherë është alternativa më e mirë për vendet në tranzicion sepse ky studim është rast konkret se si tatimi progresiv ka dhënë rezultate më të mira në rastin e Shqipërisë.
- Tatimi i sheshtë shoqërohet me një rritje ekonomike më të lartë por nga ana tjetër me një pabarazi të lartë ndërmjet shtresave të ndryshme në shoqëri.
- Tatimi progresiv ka dhënë efekt të konsiderueshëm në stabilizimin e borxhit publik ku për një periudhë prej 7 vitesh, kemi një rritje minimale të borxhit publik krahasuar me PBB-në.



- Të gjithë indikatorët ekonomik si të ardhurat tatimore, konsumi, investimet dhe deficitit buxhetorë kanë performuar më mirë gjatë periudhës së tatimit progresiv.
- Tatimi progresiv në të ardhura ka dhënë efekt në rishpërndarjen e të ardhurave dhe në uljen e varfërisë duke e lehtësuar dhe ulur barrën tatimore në shtresën e ulët dhe të mesme dhe nga ana tjetër janë shpërndarë ndihma ekonomike në mënyrë që të rimëkëmbet kjo pjesë e shoqërisë.
- Poashtu faktorët tjerë social si papunësia, koeficienti Gini kanë performuar më mirë gjatë periudhës së tatimit progresiv.

#### Rekomandimet që dalin nga ky studim janë:

Pavarsisht avantazheve të tatimit progresiv krahasuar me periudhën e tatimit të sheshtë, përsëri rezultatet që ka dhënë kjo taksë në Shqipëri nuk janë shumë të kënaqshme apo më sakt nuk i kanë arritur pritshmëritë.

Një ndër arsytet që ka ndodhur kjo është sepse, pragjet e tatimit nuk janë të qëlluara pasi janë të vendosura në atë mënyrë që edhe shtresa e mesme i nënshtrohet një norme të lartë tatimi prandaj edhe rezultati në shpërndarjen e të ardhurave nëpër shtresat e popullësisë nuk është i kënaqshëm.

Një zgjidhje për këtë do të ishte shtimi i një pragu për shtresën e mesme me një normë më të ulët se 23% për shembull:

- 0-400.000 lek janë të përjashtuar nga TP
- 400.001 deri në 1.200.000 lekë duhet të jetë 10%
- 1.200.001 lekë deri në 2.000.000 lekë të jetë 15%
- mbi 2.000.001 lekë të jetë 23%.

<i>Paga para TP</i>	<i>Tatimi progresiv aktual</i>	<i>Paga pas TP</i>	<i>Tatimi progresiv i rekomanduar</i>	<i>Paga pas TP</i>
40.000	$30.000 \times 0\% = 0$ $10.000 \times 13\% = 1.300$	<b>38.700</b>	$40.000 \times 0\% = 0$	<b>40.000</b>
150.000	$30.000 \times 0\% = 0$ $100.000 \times 13\% = 13.000$ $20.000 \times 23\% = 4.600$	<b>133.400</b>	$40.000 \times 0\% = 0$ $80.000 \times 10\% = 8.000$ $30.000 \times 15\% = 4.500$	<b>137.500</b>
230.000	$30.000 \times 0\% = 0$ $100.000 \times 13\% = 13.000$ $100.000 \times 23\% = 23.000$	<b>194.000</b>	$40.000 \times 0\% = 0$ $80.000 \times 10\% = 8.000$ $80.000 \times 15\% = 12.000$ $30.000 \times 23\% = 6.900$	<b>203.100</b>

Kjo do të bënte që:

- një punëtori me pagë 40.000 lekë me tatimin progresiv aktual do ti ngelnin neto pagë 38.700 lekë ndërsa me tatimin progresiv të rekomanduar i do ti ngelnin 40.000 lekë apo 1.300 lekë më shumë.
- një punëtori me pagë 150.000 lekë me tatimin progresiv aktual do ti ngelnin 133.400 lekë ndërsa me tatimin progresiv të rekomanduar do ti ngelnin 137.500 lekë apo 4.500 lekë më shumë
- një punëtori me pagë 230.000 lekë me tatimin progresiv aktual do ti ngelnin 194.000 lekë ndërsa me tatimin progresiv të rekomanduar do ti ngelnin 203.100 lekë apo 7.100 lekë më shumë.

Domethënë kjo metodë tatimi mundëson që shtresës së ulët dhe të mesme tu ngelet më shumë para dhe në aspekt afatgjatë efektet do të ishin më të kënaqshme duke rritur shtresën e mesme në shoqëri e cila konsiderohet edhe si shtresa më e shëndoshë dhe motorri i ekonomisë dhe poashtu shtresës së lartë i mbesin më shumë para pas tatimit gjë që nuk do të ulte nxitjet e tyre për të punuar dhe investuar.

## Bibliografia

1. Bexheti, A. (2017). *Financat Publike- botimi i dytë*.
2. (n.d.). <https://www.investopedia.com/terms/k/keynesianeconomics.asp>.
3. Klapper, S., Hysi, D., Civici, A., Xhepa, S., Gogo, G., Binaj, A., . . . Meka, E. (2020). Sfidat e zhvillimit ekonomik në Shqipëri.
4. Buffet, W. (April 2012). The Buffet Rule: "A basic principle of tax fairness. *The national Economic Council*.
5. Cecchetti, S., Mohanty, & Zam, F. (2011). The real effects of debt .  
<https://poseidon01.ssrn.com/delivery.php?ID=7270981230070930750880781181200220720520250930490280510911150640780230290701110640180290050001150060161070300280980950230980730190070130600131081200690290250040750210130850740141000940651070860310880640071060070>.
6. Diamond, P., & Saez, E. (2011). The Case for a Progressive Tax: From Basic Research to Policy Recommendations.
7. Easterly, W. (2000). The Middle Class Consensus and Economic Development.  
[https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=630718](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=630718).
8. Fejzulla, X., Lleshi, M., & Sako, M. (2015). Borxhi publik dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike. Qasje ekonometrike për periudhën 2005-2014.  
<https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/konferenca-studentore/punime-tee-publikuar>.
9. Gravelle, J., & Marples, D. (2014). Tax Rates and Economic Growth.
10. Hoxha, B., & Koçi, E. (2013). Rritja ekonomike: Një studim ekonometrik për të përcaktuar faktorët ndikues për Shqipërinë. <https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/konferenca-studentore/punime-tee-publikuar>.
11. Hungerfort, T. L. (2012). Taxes and the Economy: An economic analysis of the Top Tax Rates Since 1945.
12. INSTAT. (2019). Bilanci i energjisë elektrike. <http://www.instat.gov.al/media/5733/bilanci-i-energjis%C3%AB-elektrike-tr-i-2019.pdf>.
13. International Monetary Fund . (2008). SFIDAT E POLITIKËS FISKALE.  
<https://www.imf.org/external/np/seminars/eng/2008/alb/11.pdf>.
14. Keynesian Economics. (n.d.). <https://www.investopedia.com/terms/k/keynesianeconomics.asp>.
15. Maganya, M. H. (2011). Tax revenue and economic growth in developing country: an autoregressive distribution lags approach. <https://sciendo.com/article/10.2478/ceej-2020-0018>.
16. Mehmeti, E., & Etemi, G. (2014). Taksa progresive përballë taksës proporcionale.  
<https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/konferenca-studentore/punime-tee-publikuar>.

17. Okun, A. M. (1975). Equality and Efficiency: The Big Tradeoff. *The Brookings Institution*.
18. Politika fiskale – Objektivat, instrumentet. (n.d.). <https://econwpa.ub.uni-muenchen.de/econ-wp/pe/papers/0505/0505013.pdf>.
19. Shahi , H., & Tufa, I. (2017). Si ndikon sistemi fiskal në zhvillimin ekonomik në Shqipëri. <https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/konferenca-studentore/punime-tee-publikuar>.
20. Shano, D. (2018). Borxhi Publik dhe nevoja për të ristrukturuar ekonomine shqipëtare. [https://www.academia.edu/37464055/Borxhi\\_publik\\_dhe\\_nevoja\\_per\\_nje\\_ristrukturim\\_te\\_ekonomise](https://www.academia.edu/37464055/Borxhi_publik_dhe_nevoja_per_nje_ristrukturim_te_ekonomise).
21. Shijaku, G., & Gjakuta, A. (2013). Politika fiskale dhe rritja ekonomike: Rasti i Shqipërisë. <https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/konferenca-studentore/punime-tee-publikuar>.
22. Šokčević , S., & Štokovac, D. (n.d.). Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike në vendet e BE në tranzicion.
23. STIGLITZ, J. E. (2014). *The Price of Inequality: How Today's*. <http://www.pas.va/content/dam/accademia/pdf/es41/es41-stiglitz.pdf>.
24. Sufaj, D. (2015). Global Financial Crisis of 2007: The Case of Albania. [https://www.researchgate.net/publication/282302353\\_Global\\_Financial\\_Crisis\\_of\\_2007\\_The\\_Case\\_of\\_Albania](https://www.researchgate.net/publication/282302353_Global_Financial_Crisis_of_2007_The_Case_of_Albania).
25. **“Borxhi publik dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike. Qasje ekonometrike për periudhën 2005-2014”** studim i bërë nga Xhoi Fejzulla, Mariglëna Lleshi dhe Megi Sako

## Ueb faqet

1. <https://www.financa.gov.al/>
2. <http://www.instat.gov.al/>
3. <https://www.bankofalbania.org/>
4. <https://econwpa.ub.uni-muenchen.de/econ-wp/pe/papers/0505/0505013.pdf>
5. <https://www.tatime.gov.al/>
6. <https://www.altax.al/al/>
7. <https://www.worldbank.org/>
8. <https://ec.europa.eu/eurostat>
9. <https://www.imf.org/>
10. <https://stats.oecd.org>
11. <https://tradingeconomics.com/>
12. <https://www.statista.com/>

13. <https://mf.rks-gov.net/>
14. <https://finance.gov.mk/>
15. <http://www.fiskalnisavet.rs/>
16. <https://www.mfin.gov.rs/en/>
17. <https://seenews.com/>
18. <https://mif.gov.me/>
19. <https://www.minfin.gr/>
20. <https://www.minfin.bg/>
21. <https://mfin.gov.hr/>
22. <http://www.vijeceministara.gov.ba/>
23. <https://wid.world/>
24. <https://www.imf.org/external/np/seminars/eng/2008/alb/11.pdf>
25. <https://www.macrotrends.net>

**Appendix:**

Source	SS	df	MS	Number of obs = 13		
-----+-----				F( 4, 8) = 848.95		
Model	20763805.5	4	5190951.38	Prob > F = 0.0000		
Residual	48916.1878	8	6114.52348	R-squared = 0.9976		
-----+-----				Adj R-squared = 0.9965		
Total	20812721.7	12	1734393.47	Root MSE = 78.195		
-----						
	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
-----+-----						
teardhurattatimore	.9972644	.2266892	4.40	0.002	.4745181	1.520011
investimet	1.333991	.5184903	2.57	0.033	.1383505	2.529632
borxhipublik	.0910384	.041881	2.17	0.061	-.0055394	.1876161
konsumi	.3907917	.195827	2.00	0.081	-.0607863	.8423697
_cons	2860.378	1168.3	2.45	0.040	166.2724	5554.484
-----						